

SISTEM AUDIO NË SHTËPI

Udhëzimet e përdorimit

Fillimi

Luajtja e diskut/USB

Transferimi me USB

Sintonizuesi

Bluetooth

Rregullimi i zërit

Veprimet e tjera

Informacion shtesë

PARALAJMËRIM

Për të ulur rrezikun e zjarrit ose të goditjes elektrike, mos e ekspozoni këtë aparaturë ndaj shiut apo lagështirës.

Për të zvogëluar rrezikun e zjarrit, mos e mbuloni hapësirën e ajrimit të pajisjes me gazetë, mbulesa tavoline, perde etj.

Mos e ekspozoni pajisjen ndaj burimeve me flakë të pambrojtur (për shembull, qirinjtë e ndezur).

Për të reduktuar rrezikun e zjarrit apo goditjes elektrike, mos e ekspozoni këtë pajisje ndaj spërkatjeve apo pikimeve dhe mos vendosni mbi pajisje objekte që përmbajnë lëngje, siç janë vazot.

Duke qenë se spina kryesore përdoret për të shkëputur njësinë nga rrjeti elektrik, lidhjeni njësinë në një prizë AC që mund të arrihet lehtë. Nëse vini re ndonjë anomali me njësinë, shkëputeni spinën kryesore menjëherë nga priza AC.

Mos e instaloni pajisjen në një hapësirë të ngushtë, si p.sh. raft librash apo kabinet inkaso.

Mos ekspozoni bateritë apo pajisjet me bateri të instaluar ndaj nxehtësisë së lartë, si p.sh. ndaj dritës së diellit dhe zjarrit.

Njësia nuk shkëputet nga rrjeti elektrik për sa kohë që është e lidhur me prizën AC, edhe nëse vetë njësia është fikur.

Kjo pajisje është testuar dhe është konstatuar se përputhet me limitet e përcaktuara nga Direktiva EMC me një kablo lidhëse më të shkurtër se 3 metra.

KUJDES

Përdorimi i instrumenteve optike me këtë produkt do të rrisë rrezikun për sytë.



Kjo pajisje klasifikohet si produkt CLASS 1 LASER. Ky shënim ndodhet në pjesën e jashtme të pasme.

Kur shpaketoni ose lëvizni një altoparlant të madh dhe/ose të rëndë, sigurohuni që njësia të lëvizet me një ose dy persona. Rënia e njësisë mund të shkaktojë lëndime personale dhe/ose dëmtrim të pronës.

Për klientët në Shtetet e Bashkuara

Regjistri i zotëruesit

Modeli dhe numrat serialë ndodhen në pjesën e pasme të njësisë. Regjistrojini këto numra në hapësirën e dhënë më poshtë. Referojuni atyre sa herë që telefoni shitësin tuaj të Sony në lidhje me këtë produkt.

Nr. i modelit _____

Nr. serial _____



Ky simbol përdoret për të sinjalizuar përdoruesin mbi praninë e "tensionit të rrezikshëm" të paizoluara brenda produktit, i cili mund të jetë i shkallës së mjaftueshme për të përbërë rrezik për goditje elektrike ndaj personave.



Ky simbol përdoret për të sinjalizuar përdoruesin mbi praninë e udhëzimeve të rëndësishme të përdorimit dhe mirëmbajtjes (shërbimit) në literaturën që shoqëron pajisjen.

Udhëzime të rëndësishme mbi sigurinë

- 1) Lexojini këto udhëzime.
- 2) Zbatojini këto udhëzime.
- 3) Kushtojuni kujdes të gjitha paralajmërimeve.

- 4) Ndiqini të gjitha udhëzimet.
- 5) Mos e përdorni këtë aparaturë pranë ujit.
- 6) Pastrojeni vetëm me një copë të thatë.
- 7) Mos bllokoni vrimat e ajrosjes.
Instalojeni në përputhje me udhëzimet e prodhuesit.
- 8) Mos e instaloni pranë burimeve të nxehtësisë, si p.sh. radiatorëve, daljeve të ngrohjes qendrore, sobave, apo aparatrave të tjera (duke përfshirë amplifikatorët) që prodhojnë nxehtësi.
- 9) Mos shpërfillni qëllimin e sigurisë për prizë të polarizuar ose me tokëzim. Një spinë e polarizuar ka dy kunjat njëra është më e gjatë se tjetra. Një spinë e tokëzuar ka dy kunjat dhe një të tretë për tokëzim. Kunji i gjërë ose kunji i tretë ofrohen për sigurinë tuaj. Nëse spina e dhënë nuk futet në prizën tuaj, konsultohuni me një elektrikist për zëvendësimin e prizës së vjetër.
- 10) Mbroni kordonin e rrymës që të mos shkelet apo pickohet, veçanërisht te spinat, prizat dhe në pikën ku ato dalin nga aparati.
- 11) Përdorni vetëm aksesorët e specifikuar nga prodhuesi.
- 12) Përdoreni vetëm me karrelën, mbajtësen, këmbalecin, kapësen apo tavolinën e specifikuar nga prodhuesi, ose që shitet me aparaturën. Kur përdoret një karrelë, kushtoni vëmendje kur lëvizni kombinimin karrelë/apaturë për të shmangur lëndimet nga pengimi në të.



- 13) Shkëputeni këtë aparaturë nga priza gjatë stuhive me vetëtimat ose kur nuk përdoret për periudha të gjata kohe.
- 14) Për të gjitha shërbimet, referojuni personelit të kualifikuar të shërbimit. Kërkohet shërbim kur aparatura është dëmtuar në ndonjë mënyrë, si p.sh. nëse është dëmtuar kordoni i furnizimit me rrymë ose priza, nëse mbi aparaturë janë

derdhur lëngje ose kanë rënë objekte, nëse aparatura është ekspozuar ndaj shiut ose lagështirës, nëse nuk punon siç duhet ose nëse është rrëzuar.

Deklarata e mëposhtme FCC aplikohet vetëm për versionin e këtij modeli të prodhuar për shitje në SH.B.A. Versionet e tjera mund të mos përputhen me rregulloret teknike të FCC.

SHËNIM:

Kjo pajisje është testuar dhe është gjendur konform limiteve për pajisjet dixhitale të Klazit B, në përputhje me pjesën 15 të Rregulloreve FCC. Këto limite përcaktohen për të ofruar mbrojtje të arsyeshme kundër interferencave të dëmshme kur instalohet në ambient banimi. Kjo pajisje krijon, përdor dhe mund të rrezatojë energji radiofrekuence, dhe nëse nuk instalohet dhe përdoret në përputhje me udhëzimet, mund të shkaktojë interferencë të dëmshme ndaj komunikimeve radio. Megjithatë, nuk garantohej që nuk do të ndodhë interferencë në një instalim të caktuar. Nëse kjo pajisje nuk shkakton interferencë të dëmshme ndaj marrjes radiotelevizive, gjë që mund të përcaktohet duke fikur dhe ndezur pajisjen, përdoruesi inkurajohet që të provojë të korrigjojë interferencën me një ose më shumë nga masat e mëposhtme:

- Riorientoni ose zhvendosni antenën marrëse.
- Rrisni ndarjen mes pajisjes dhe marrësit.
- Lidhni pajisjen në një prizë në një qark të ndryshëm nga ai ku është lidhur marrësi.
- Për ndihmë konsultohuni me shitësin ose një teknik me përvojë për radio/televizorë.

KUJDES

Duhet të keni parasysh që çdo ndryshim apo modifikim që nuk miratohet shprehimisht në këtë manual mund të anulohet autoritetin tuaj për të përdorur këtë pajisje.

Për pritjen e kompjuterëve dhe/ose aksesoreve duhet të përdoren kablo të tokëzuara dhe të izoluar mirë, për të arritur limitet e FCC për emetimet.

Kjo pajisje nuk duhet të vendoset apo përdoret së bashku me një antenë apo transmetues tjetër.

Kjo pajisje pajtohet me limite e ekspozimit të rrezatimit të FCC të përcaktuara për një mjedis të pakontrolluar dhe plotëson Direktivat e Ekspozimit të radiofrekuencës (FR) të FCC në Suplementin C të OET65. Kjo pajisje ka nivele shumë të ulëta të energjisë RF që përcaktohen si të pajtueshme pa vlerësimin maksimal të ekspozimit të lejueshëm (MPE). Por, është e dëshirueshme që ajo të instalohet dhe përdoret duke mbajtur radiatorin të paktën 20 cm ose më shumë nga trupi i personave (duke përfshirë gjymtyrët: duart, kyçet, këmbët dhe kyçet e këmbëve).

Për klientët në Evropë



Hedhja e pajisjeve të vjetra elektrike dhe elektronike (e aplikueshme në Bashkimin Evropian dhe vendet e tjera evropiane me sisteme grumbullimi të diferencuar)

Ky simbol mbi produkt ose mbi paketimin e tij tregon se ky produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake. Përkundrazi, do të dorëzohet pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike. Duke u siguruar që ky produkt të hidhet siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të

mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin, që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të këtij produkti. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore. Për informacion të detajuar mbi riciklimin e këtij produkti, kontaktoni me bashkinë tuaj, shërbimin e hedhjes së mbetjeve shtëpiake, ose dyqanin ku keni blerë produktin.



Hedhja e baterive të vjetra (e aplikueshme në Bashkimin Evropian dhe vendet e tjera evropiane me sisteme grumbullimi të diferencuar)

Ky simbol mbi bateri ose mbi paketim tregon se bateria që jepet me këtë produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake. Në disa bateri, ky simbol mund të përdoret i kombinuar me një simbol kimik. Simbolet kimike për zhivën (Hg) ose plumbin (Pb) shtohen nëse bateria përmban më shumë se 0,0005% zhivë ose 0,004% plumb. Duke u siguruar që këto bateri të hidhen siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të kësaj baterie. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore. Në rast produktesh të cilat për arsye sigurie, rendimenti apo integriteti të dhënash kërkojnë lidhje të qëndrueshme me një bateri të inkomporuar, kjo bateri duhet të zëvendësohet vetëm nga personel i kualifikuar shërbimi. Për të siguruar trajtimin e duhur të baterisë, dorëzoheni produktin në fund të periudhës së funksionimit të tij pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike.

Për të gjitha bateritë e tjera, ju lutemi shihni pjesën që flet mbi heqjen e sigurt të baterisë nga produkti. Dorëzoheni baterinë pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e baterive të përdorura. Për informacion të detajuar mbi riciklimin e këtij produkti ose kësaj baterie, kontaktoni me bashkinë tuaj, shërbimin e hedhjes së mbetjeve shtëpiake, ose dyqanin ku keni blerë produktin.

Shënim për klientët: Informacioni i mëposhtëm aplikohet vetëm për pajisjet që shiten në vende që aplikojnë Direktivat e BE-së.

Ky produkt është prodhuar nga ose për llogari të Sony Corporation, 1-7-1 Konan Minato-ku Tokyo, 108-0075 Japoni. Pyetjet në lidhje me pajtueshmërinë e produktit bazuar në legjislacionin e Bashkimit Evropian, duhet t'i drejtohen përfaqësuesit të autorizuar, Sony Deutschland GmbH, Hedelfinger Strasse 61, 70327 Stuttgart, Gjermani. Për çdo çështje shërbimi apo garancie, referojuni adresave të dhëna në dokumentet e veçanta të shërbimit apo garancisë.

Përmes kësaj, Sony Corp., deklaron se kjo pajisje është në përputhje me kërkesat themelore dhe dispozitat e tjera përkatëse të Direktivës 1999/5/EC.

Për detaje, ju lutemi vizitoni URL-në e mëposhtme:

<http://www.compliance.sony.de/>



Për klientët në Australi



Hedhja e pajisjeve të vjetra elektrike dhe elektronike (e aplikueshme në Bashkimin Evropian dhe vendet e tjera evropiane me sisteme

grumbullimi të diferencuar)

Njoftim mbi licencat dhe markat tregtare

- Logoja "WALKMAN" dhe "WALKMAN" janë marka tregtare të regjistruara të Sony Corporation.
- Teknologjia e kodimit audio MPEG Layer-3 dhe patentat janë të licencuara nga Fraunhofer IIS dhe Thomson.
- Windows Media është markë tregtare e regjistruar ose markë tregtare e Microsoft Corporation në Shtetet e Bashkuara dhe/ose vende të tjera.
- Ky produkt është i mbrojtur nga të drejta të caktuara të pronës intelektuale të Microsoft Corporation. Përdorimi ose shpërndarja e kësaj teknologjie jashtë këtij produkti ndalohet pa një licencë nga Microsoft ose një filial i autorizuar i Microsoft.
- Logoja dhe marka e fjalës *Bluetooth*[®] janë marka tregtare të regjistruara nga Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorimi këtyre markave nga Sony Corporation është me licencë. Markat tregtare dhe emrat tregtarë të tjerë janë të zotëruesve të tyre përkatës.
- Shenja N është markë tregtare ose markë tregtare e regjistruar e NFC Forum, Inc. në Shtetet e Bashkuara dhe në vende të tjera.
- Android është markë tregtare e Google Inc.
- Të gjitha markat e tjera tregtare dhe markat tregtare të regjistruara janë të zotëruesve të tyre përkatës. Në këtë manual nuk janë specifikuar markat TM dhe [®].

Pasqyra e lëndës

Udhëzuesi i pjesëve dhe komandimeve.....	7
--	---

Fillimi

Montimi i sigurt i sistemit	10
Pozicionimi i altoparlantëve	12
Vendosja e orës	12

Luajtja e diskut/USB

Luajtja e një disku	12
Përpara përdorimit të pajisjes USB me këtë sistem	13
Luajtja e një pajisjeje USB.....	13
Kërkimi i një pjese ose skedari audio (Kërkimi i pjesës)	14
Përdorimi i modalitetit të luajtjes	14

Transferimi me USB

Transferimi i muzikës	16
-----------------------------	----

Sintonizuesi

Dëgjimi i radios.....	19
-----------------------	----

Bluetooth

Mbi teknologjinë <i>Bluetooth</i> me valë.....	20
Dëgjimi i muzikës me valë në një pajisje <i>Bluetooth</i>	20
Vendosja e kodekëve të audios <i>Bluetooth</i>	24
Vendosja/anulimi i modalitetit të gatishmërisë së <i>Bluetooth</i>	25

Rregullimi i zërit

Rregullimi i zërit.....	25
Krijimi i tingullit tuaj zanor personal.....	26
Krijimi i një atmosfere festive (DJ EFFECT).....	26

Veprimet e tjera

Shoqërimi i këngës	27
Ndryshimi i motivit të ndriçimit dhe ngjyrës.....	27
Përdorimi i kohëmatësve.....	27
Ndryshimi i afishimit.....	28
Përdorimi i pajisjeve opsionale... ..	29
Çaktivizimi i butonave në njësi (Bllokimi për fëmijët)	30
Vendosja/anulimi i funksionit të gatishmërisë automatike (Vetëm për modelin e Evropës)	30


Informacion shtesë

Disqet që mund të luhen	31
Uebfaqet për pajisjet e përputhshme	32
Zgjidhja e problemeve	32
Mesazhet	37
Masat paraprake	38
Specifikimet.....	40


Udhëzuesi i pjesëve dhe komandimeve

Ky manual shpjegon kryesisht veprimet me telekomandën, por të njëjtat veprime mund të kryhen duke përdorur butonat në njësi që kanë emër të njëjtë ose të ngjashëm.

Njësia



Telekomanda RM-AMU163



1  (**ndezur/në gatishmëri**)

Ndizni sistemin, ose vendoseni në modalitetin e gatishmërisë.

2 **MUSIC, MOVIE/GAME, FOOTBALL**

Zgjidhni efektin e paravendosur të zërit (faqe 25).

Njësia: BASS BAZUCA (faqe 25)

Shtypeni për të zgjedhur efektin BASS BAZUCA.


Mbajeni shtypur për të zgjedhur efektin BASS CUT.

3 

Zgjidhni artikujt e menysë.

 **+/- (zgjidh dosjen)**

Zgjidhni një dosje në një disk MP3 ose një pajisje USB.

 **(përshejto prapa/përshejto para)**

Mbajeni shtypur për të gjetur një pikë në një pjesë ose skedar gjatë luajtjes.

 **(shko prapa/shko përpara)**

Zgjidh një pjesë ose skedar.

TUNING+/-

Sintonizohuni në stacionin që dëshironi.

 **(ndal)**


Ndaloni luajtjen.


Shtypeni dy herë për të anuluar rifillimin e luajtjes së pajisjes USB.



Njësia: ENTER

Telekomanda: 

Vendosni cilësimet.

Njësia:  **II (luaj/vendos në pauzë)**

Telekomanda:  **(luaj)*, II (vendos në pauzë)**

Filloni ose vendosni në pauzë luajtjen. Për të rifilluar luajtjen, shtypni  ose .

4 **Njësia: VOLUME/DJ CONTROL**

Rregulloni volumnin.

Rregulloni nivelin e DJ EFFECT (faqe 26).

Këtë çelës nuk mund ta përdorni për të rregulluar volumnin kur aktivizohet DJ EFFECT.

Telekomanda: VOLUME +/-*

Rregulloni volumnin.

Telekomanda: DJ CONTROL +/-

Rregulloni nivelin e DJ EFFECT.

5 **Sirtari i diskut**

6  **OPEN/CLOSE**

Futni ose nxirrni një disk.

7  **(Shenja N) (faqe 22)**

Treguesi i pikës së prekjes së Near Field Communication (NFC).

8 **LED PATTERN (faqe 27)**

Ndryshoni motivin e ndriçimit në altoparlantë dhe njësi.

LED COLOR (faqe 27)


Ndryshoni ngjyrën e ndriçimit në altoparlantë dhe njësi.

9 **OPTIONS**

Hyni ose dilni nga menyuja e opsioneve.

- 10 CD**
Zgjidhni funksionin CD.
Njësia: USB/USB SELECT
Telekomanda: USB
Zgjidhni funksionin USB.
Zgjidhni pajisjen USB të lidhur me portën Ψ A ose portën Ψ B gjatë funksionit USB.
- Njësia: TUNER/BAND**
Zgjidhni funksionin TUNER.
Zgjidhni bandën FM ose AM gjatë funksionit TUNER.
- Njësia: AUDIO IN**
Zgjidhni funksionin TV/DVD/SAT ose PC/GAME.
- Telekomanda: FUNCTION**
Zgjidhni një funksion.
- 11 Paneli i ekranit**
- 12 Paneli i poshtëm (faqe 11)**
- 13 REC TO USB B**
Transferoni në pajisjen opsionale USB që është e lidhur me portën Ψ B.
- 14 Porta Ψ B (REC/PLAY) (USB)**
Lidhni dhe transferoni në një pajisje opsionale USB.
- 15 Foleja MIC**
Lidhni një mikrofon.
MIC LEVEL (MIN/MAX)
Rregulloni volumnin e mikrofonit.
- 16 Porta Ψ A (PLAY) (USB)**
Lidhni një pajisje opsionale USB.
- 17 FLANGER, ISOLATOR, SOUND FLASH, PHASER (faqe 26)**
Zgjidhni llojin e DJ EFFECT.
- 18 Sensori i telekomandës**
- 19 BLUETOOTH (faqe 21, 23)**
Shtypni për të zgjedhur funksionin *Bluetooth*.
Mbajeni shtypur për të aktivizuar çiftimin *Bluetooth* gjatë funksionit *Bluetooth*.
- 20 SLEEP (faqe 27)**
Vendosni kohëmatësin e fjetjes.
- 21 REPEAT/FM MODE**
Dëgjoni një disk, një pajisje USB, një pjesë apo skedar individual në mënyrë të përsëritur (faqe 15).
Zgjidhni modalitetin e marrjes FM (mono ose stereo) (faqe 19).
- 22 DISPLAY**
Ndryshoni informacionin në panelin e ekranit.
- 23 SEARCH/TUNER MEMORY**
Hyni ose dilni nga modaliteti i kërkimit.
Paravendosni stacionin e radios (faqe 19).
- 24 CLEAR**
Fshini hapin e fundit nga lista e programeve.
- 25 TIMER MENU (faqe 12, 28)**
Vendosni orën dhe kohëmatësit.
- 26 PLAY MODE/TUNING MODE**
Zgjidhni modalitetin e luajtjes së një disku AUDIO CD, MP3 ose një pajisjeje USB (faqe 14).
Zgjidhni modalitetin e sintonizimit (faqe 19).
- * Butonat VOLUME + dhe ► kanë një pikë të prekshme. Përdorni pikën e prekshme si referencë kur përdorni sistemin.


Montimi i sigurt i sistemit




A Antenat

Gjeni një vendndodhje dhe orientim që ofron marrje të mirë kur vendosni antenat.

Mbajini antenat larg kordonëve të altoparlantëve, kordonit të rrymës dhe kabllot USB për të shmangur kapjen e zhurmave.



Shembull:



Shënime

- Sigurohuni të përdorni vetëm altoparlantët e dhënë.
- Kur lidhni kordonët e altoparlantëve, futni kabllon direkt në terminale.

– Terminalet LED SPEAKER

Lidhni kabllon LED SPEAKER e altoparlantit me këtë terminal.

Ndriçimi në altoparlantë do të reagojë sipas burimit të muzikës. Ju mund të zgjidhni motivin e ndriçimit dhe ngjyrën sipas preferencës suaj (faqe 27).

Shembull:



B Altoparlantët

– Terminalet TWEETERS/WOOFERS dhe SUBWOOFERS

Kordonët e altoparlantëve janë të koduar me ngjyra me terminalet përkatëse në njësi.

C Foletë AUDIO IN

Përdorni një kordon audio (nuk jepet) për t'u lidhur me foletë e daljes audio të pajisjeve të mëposhtme. Zëri del përmes këtij sistemi.

– TV/DVD/SAT L/R

Lidhni me një TV ose një pajisje audio/video.

– PC/GAME L/R

Lidhni me një kompjuter ose pajisje për lojëra.


D Energjia

Fusni kordonin e rrymës në prizë. Demonstrimi shfaqet në panelin e ekranit. Shtypni I/⏻ për të aktivizuar sistemin dhe demonstrimi përfundon automatikisht.

Nëse adaptori i dhënë në prizë nuk përputhet me prizën tuaj të murit, shkëputeni nga priza (vetëm për modelet me adaptor).

Futja e baterive

Fusni dy bateri të dhëna R6 (përmasa AA), duke përputhur polaritetet e treguara më poshtë.




Shënime

- Mos përzieni një bateri të vjetër me një të re ose mos përzieni lloje të ndryshme baterish.
- Nëse nuk do ta përdorni telekomandën për një kohë të gjatë, hiqni bateritë për të shmangur dëmtimet nga rrjedhja dhe gërryerja e baterisë.


Vendosja e panelit të poshtëm

Ju mund të vendosni panelin e poshtëm të dhënë në fund të njësisë kryesore për të ngritur panelin e përparmë dhe për të lehtësuar përdorimin.

1 Fusni grepat e panelit të poshtëm në vrimat kapëse në pjesën e poshtme të njësisë kryesore.




2 Fusni kunjat e panelit të poshtëm në vrimat kapëse. Më pas, shtyni panelin e poshtëm derisa të ngecë në njësinë kryesore.



Pozicionimi i altoparlantëve

Për të arritur performancë optimale nga sistemi, rekomandojmë që të vendosni altoparlantët siç tregohet më poshtë.

- (A) Njësia
- (B) Altoparlanti (majtas)
- (C) Altoparlanti (djathtas)



Vendosja e orës

Ju nuk mund ta vendosni orën në modalitetin e kursimit të energjisë.

1 Shtypni **I/⏻** për të ndezur sistemin.

2 Shtypni **TIMER MENU**.

Nëse shfaqet "PLAY SET" në panelin e ekranit, shtypni **↕/↔** në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "CLOCK SET", më pas shtypni **⊕**.

3 Shtypni **↕/↔** në mënyrë të përsëritur për të vendosur orën, më pas shtypni **⊕**.


4 Shtypni **↕/↔** në mënyrë të përsëritur për të vendosur minutat, më pas shtypni **⊕**.

Luajtja e diskut/USB

Luajtja e një disku

- 1** Shtypni **CD**.
- 2** Shtypni **⏮ OPEN/CLOSE** në njësi.
- 3** Ngarkoni një disk me anën e etiketës me pamje lart në sirtarin e diskut.

Kur luani një disk 8 cm si p.sh. një këngë në CD, vendoseni në rrethin e brendshëm të sirtarit



4 Shtypni **⏮ OPEN/CLOSE** në njësi për të mbyllur sirtarin e diskut.

Mos e shtypni me forcë sirtarin e diskut për ta mbyllur sepse kjo mund të shkaktojë keqfunksionim.

5 Shtypni **▶** për të filluar luajtjen.

Përpara përdorimit të pajisjes USB me këtë sistem

Kontrolloni uebsajtet për informacion mbi pajisjet e përputhshme USB (faqe 32).







Për të përzgjedhur burimin e luajtjes ose destinacionin e transferimit (zgjedhja e memories së USB)

Nëse pajisja USB ka më shumë se një memorie (për shembull, memorie të brendshme dhe kartë memorieje), ju mund të zgjidhni se cilën memorie të përdorni si burim luajtje ose destinacion transferimi.

Përdorni butonat në njësi për ta kryer këtë veprim.

Shënim

Ju nuk mund të zgjidhni një memorie gjatë luajtjes ose transferimit. Sigurohuni që të zgjidhni një memorie përpara se të filloni luajtjen ose transferimin.



- 1 Shtypni USB/USB SELECT në mënyrë të përsëritur derisa në panelin e ekranit të ndizet "USB A" ose "USB B".
- 2 Lidhni pajisjen USB me portën  A ose  B.
- 3 Shtypni OPTIONS kur ndalohet luajtja.
- 4 Shtypni  /  për të zgjedhur "USB MEM SEL", më pas shtypni ENTER.
- 5 Shtypni  /  për të zgjedhur memorien që dëshironi, më pas shtypni ENTER.


Luajtja e një pajisjeje USB

Formatet audio që mund të luhen nga ky sistem janë si më poshtë:


- MP3: prapashtesa e skedarit ".mp3"
- WMA: prapashtesa e skedarit ".wma"
- AAC: prapashtesa e skedarit ".m4a", ".mp4" ose ".3gp"

Nëse skedarët audio kanë prapashtesën e mësipërme të skedarit, por nuk janë në formatet përkatëse, sistemi mund të prodhojë zhurmë ose mund të keqfunksionojë.

- 1 Shtypni USB në mënyrë të përsëritur derisa në panelin e ekranit të ndizet "USB A" ose "USB B".
- 2 Lidhni një pajisje USB me portën  A ose  B.



Shënim

Ju mund të përdorni një adaptor USB (nuk jepet) për të lidhur pajisjen USB me njësinë, nëse pajisja USB nuk mund të lidhet me portën .

- 3 Shtypni .

Skedarët audio luhen në rende të ndryshme në varësi të modalitetit të luajtjes.

Kërkimi i një pjese ose skedari audio

(Kërkimi i pjesës)

1 Shtypni SEARCH.

"SEARCH" ndizet në panelin e ekranit.

2 (Vetëm skedarët audio) Shtypni \uparrow/\downarrow për të zgjedhur dosjen që dëshironi, më pas shtypni \oplus ose \blacktriangleright .

3 Shtypni \uparrow/\downarrow për të zgjedhur pjesën ose skedarin audio që dëshironi, më pas shtypni \oplus ose \blacktriangleright .

Pjesa ose skedari audio i përzgjedhur fillon luajtjen.

Shënime mbi disqet

- (Për AUDIO CD) Ky sistem mund të njohë deri në 99 pjesë.
- (Për disqe MP3) Ky sistem mund të njohë deri në
 - 999 dosje (duke përfshirë dosjen rrënjë).
 - 999 skedarë MP3.
 - 250 skedarë MP3 në një dosje.
 - 8 nivele dosjesh (strukturë pemë të skedarëve).
- Informacioni CD-TEXT nuk mbështetet.

Shënime mbi pajisjen USB

- Ky sistem mund të njohë deri në
 - 250 skedarë audio në një dosje.
 - 3000 skedarë audio në një pajisje USB.
 - 1000 dosje në një pajisje USB (duke përfshirë dosjen rrënjë).

Përdorimi i modalitetit të luajtjes

Luajtja në rendin original (Luajtja normale)

Shtypni PLAY MODE në mënyrë të përsëritur kur luajtja ka ndaluar.

Kur luani një disk

- (bosh): luaj një disk
- FLDR*: luaj të gjithë skedarët audio në dosjen në disk
- * Kur luhet një AUDIO CD, "FLDR" kryen të njëjtin veprim si modaliteti i luajtjes "(bosh)".

Kur luhet një pajisje USB

- ALL USB: luaj të gjitha pajisjet USB
- 1 USB: luaj një pajisje USB
- FLDR: luaj të gjithë skedarët audio në dosjen në pajisjen USB

Luajtja në rendin e rastësishëm (Luajtja me përzjerje)

Shtypni PLAY MODE në mënyrë të përsëritur kur luajtja ka ndaluar.

Kur luani një disk

- SHUF: përziej një disk
- FLDR SHUF*: përziej të gjithë skedarët audio në dosjen në disk
- * Kur luhet një AUDIO CD, "FLDR SHUF" kryen të njëjtin veprim si modaliteti i luajtjes "SHUF".

Kur luhet një pajisje USB

- ALL USB SHUF: përziej të gjitha pajisjet USB
- 1 USB SHUF: përziej një pajisje USB
- FLDR SHUF: përziej të gjithë skedarët audio në dosjen në pajisjen USB

Shënim

Kur fikni sistemin, Luajtja me përzjerje e zgjedhur largohet dhe modaliteti i luajtjes kthehet në Luajtje normale.

Krijimi i programit tuaj personal (Luajtja e programit)

Ju mund të krijoni një program prej deri në 25 hapa sipas rendit që dëshironi që të luhet.

1 Për funksionin CD:


Shtypni CD për të zgjedhur funksionin CD.

Për funksionin USB:


Shtypni USB në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur pajisjen USB që dëshironi.

2 Kur ndalon luajtja, shtypni PLAY MODE në mënyrë të përsëritur derisa në panelin e ekranit të ndizet "PGM".

3 (Vetëm skedarët audio) Shtypni +/- në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur një dosje.

Nëse dëshironi të programoni të gjithë skedarët në dosje, shtypni .

4 Shtypni në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur pjesën ose skedarin audio që dëshironi, më pas shtypni .



"---" shfaqet kur koha e luajtjes kalon 100 minuta për një AUDIO CD ose kur programoni një skedar audio.

5 Përsërit hapat 3 deri 4 për të programuar pjesë apo skedarë audio shtesë.

6 Shtypni për të filluar Luajtjen e programit.

Për të fshirë hapin e fundit nga lista e programeve

Shtypni CLEAR kur ndalohet luajtja.

Për të anuluar Luajtjen e programit



Kur ndalon luajtja, shtypni PLAY MODE në mënyrë të përsëritur derisa nga paneli i ekranit të zhduket "PGM".

Shënime

- (Vetëm funksioni CD) Lista e programit largohet kur hapni sirtarin e diskut.
- (Vetëm funksioni USB) Lista e programit largohet kur:
 - kryeni veprimin e fshirjes.
 - hiqni pajisjen USB.
 - ndryshoni përzgjedhjen e memories USB.

Luajtja në mënyrë të përsëritur (Luajtja me përsëritje)

Shtypni në mënyrë të përsëritur REPEAT.

-  : përsërit të gjitha pjesët ose skedarët audio në një dosje/disk/pajisje USB
-  1: përsërisni një pjesë ose skedar audio

Shënime mbi pajisjen USB

- Rendi i luajtjes për sistemin mund të ndryshojë nga rendi i luajtjes së luajtësit të lidhur dixhital të muzikës.
- Nuk mund t'i fshini skedarët audio dhe dosjet në Luajtjen me përzjerje ose Luajtjen e programit.

Transferimi i muzikës

Ju mund të transferoni muzikë nga një burim zëri në një pajisje USB të lidhur me portën Ψ B.

Formati audio i skedarëve të transferuar nga ky sistem është MP3. Megjithatë, ju mund të transferoni gjithashtu edhe skedarë WMA dhe AAC nga USB A.

Shënime

- Mos e hiqni pajisjen USB gjatë transferimit apo fshirjes. Nëse veproni ashtu mund të dëmtoni të dhënat në pajisjen USB ose të dëmtoni vetë pajisjen USB.
- Skedarët MP3/WMA/AAC transferohen me të njëjtën shpejtësi bit si skedarët origjinalë.
- Kur transferoni nga funksioni AUDIO CD, TUNER, TV/DVD/SAT ose PC/GAME, ju mund të zgjidhni shpejtësinë në bit përpara transferimit.
- Funksionet e transferimit me USB dhe fshirjes çaktivizohen kur sirtari i diskut hapet.

Shënim mbi përbajtjet e mbrojtura me të drejtë autori

Muzika e transferuar kufizohet vetëm për përdorim privat. Përdorimi i muzikës prej këtij limiti kërkon leje nga mbajtësit e të drejtës së autorit.

Për të përzgjedhur burimin e luajtjes ose destinacionin e transferimit (zgjedhja e memories së USB)

Shihni faqe 13.

Për të zgjedhur shpejtësinë bit të

Ju mund të zgjidhni një shpejtësi më të lartë bit për të transferuar muzikë me cilësi më të mirë.

Përdorni butonat në njësi për ta kryer këtë veprim.

1 Shtypni OPTIONS.

2 Shtypni \uparrow/\downarrow në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "REC BIT RATE", më pas shtypni ENTER.

3 Shtypni \uparrow/\downarrow në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur shpejtësinë bit që dëshironi, më pas shtypni ENTER.


- 128 KBPS: pjesët e koduara MP3 kanë përmasë më të vogël skedari dhe cilësi më të ulët audio.
- 256 KBPS: pjesët e koduara MP3 kanë përmasë më të madhe skedari, por cilësi më të lartë audio.

Transferimi i muzikës nga një disk apo pajisje USB

Ju mund të transferoni me lehtësi të gjithë muzikën në një disk apo USB A te USB B (Transferimi i sinkronizuar). Ju mund të transferoni gjithashtu një pjesë apo skedar audio individual gjatë luajtjes (Transferimi me REC1).

Përdorni butonat në njësi për ta kryer këtë veprim.

1 Lidhni një pajisje të transferueshme USB me portën Ψ B siç tregohet më poshtë.



Shënim

Ju mund të përdorni një adaptor USB (nuk jepet) për të lidhur pajisjen USB me njësinë, nëse pajisja USB nuk mund të lidhet me portën Ψ .

2 Për disqet:

Shtypni CD dhe më pas ngarkoni diskun.

Për USB:

Shtypni USB/USB SELECT në mënyrë të përsëritur derisa në panelin e ekranit të ndizet "USB A" dhe më pas lidhni një pajisje USB që dëshironi të transferoni te porta Ψ A.

3 Për Transferimin e sinkronizuar:

Kur ndalon luajtja, shtypni PLAY MODE në telekomandë në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur modalitetin e luajtjes që dëshironi.

Shënime

- Nëse filloni të transferoni në Luajtjen me përzierje ("FLDR SHUF"), modaliteti i përzgjedhur i luajtjes ndryshon automatikisht në "FLDR".
- Nëse filloni të transferoni në Luajtjen me përzierje (përveç "FLDR SHUF"), Luajtjen me përsëritje ose Luajtjen e programit pa hapa, modaliteti i përzgjedhur i luajtjes ndryshon automatikisht në Luajtje normale.

Për Transferimin me REC1:

Zgjidhni pjesën ose skedarin audio që dëshironi të transferoni, më pas filloni luajtjen.

4 Shtypni REC TO USB B.

"PUSH ENTER" shfaqet në panelin e ekranit.

5 Shtypni ENTER.

Transferimi fillon kur shfaqet "DON'T REMOVE" në panelin e ekranit.

Për Transferimin e sinkronizuar:

Kur kryhet transferimi, burimi i transferimit dhe pajisja USB ndalojnë automatikisht.

Për Transferimin me REC1:

Kur kryhet transferimi, disku ose pajisja USB vazhdojnë të luhen.

Transferimi i audios analoge (Transferimi analog)

Ju mund të transferoni tingull nga një burim analog audio (përveç funksionit CD, USB ose *Bluetooth*) në një pajisje USB.

Përdorni butonat në njësi për ta kryer këtë veprim.

1 Lidhni një pajisje të transferueshme USB me portën Ψ B (faqe 16).

2 Shtypni TUNER/BAND ose AUDIO IN në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur burimin që doni të transferoni.

3 Shtypni REC TO USB B.

"PUSH ENTER" shfaqet në panelin e ekranit.

4 Shtypni ENTER.

Transferimi fillon kur shfaqet "DON'T REMOVE" në panelin e ekranit.

5 Filloni luajtjen e burimit.

Për të ndaluar transferimin

Shtypni \blacksquare .

Për të krijuar një skedar të ri MP3

Shtypni REC TO USB B gjatë Transferimit analog.

"NEW TRACK" shfaqet në panelin e ekranit.

Krijohet gjithashtu automatikisht një MP3 e re pas rreth 1 ore nga transferimi.

Shënime

- Kur krijohet një skedar i ri MP3, transferimi çaktivizohet për momentin.
- Nëse shtypni sërish pas pak sekondash REC TO USB B, mund të krijohet një skedar i ri MP3.

Fshirja e skedarëve audio ose dosjeve nga pajisja USB

Përdorni butonat në njësi për ta kryer këtë veprim.

1 Shtypni **USB/USB SELECT** në mënyrë të përsëritur derisa "**USB A**" ose "**USB B**" të ndizet në panelin e ekranit kur ndalon luajtjen.

2 Shtypni **◀◀/▶▶** ose **⏪/⏩** në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur skedarin audio ose dosjen.

3 Shtypni **OPTIONS**.

4 Shtypni **↕/↕** për të zgjedhur "**USB ERASE**", më pas shtypni **ENTER**.

"**FOLDER ERASE**" ose "**TRACK ERASE**" shfaqet në panelin e ekranit.

5 Shtypni **ENTER**.

"**COMPLETE**" shfaqet në panelin e ekranit.

Rregullat e krijimit të dosjeve dhe të skedarëve

Kur transferoni në një pajisje USB, direkt nën dosjen "**ROOT**" krijohet një dosje "**MUSIC**". Dosjet dhe skedarët krijohen brenda kësaj dosjeje "**MUSIC**" si më poshtë sipas metodës dhe burimit të transferimit.

Transferimi i sinkronizuar

Burimi	Emri i dosjes	Emri i skedarit
Skedarët audio	Njësoj si burimi	
AUDIO CD	"CDDA0001"*	"TRACK001"*

Transferimi me REC1

Burimi	Emri i dosjes	Emri i skedarit
Skedarët audio	"REC1-MP3"	Njësoj si burimi
AUDIO CD	"REC1-CD"	"TRACK001"*

Transferimi analog

Burimi	Emri i dosjes	Emri i skedarit
FM	"TUFM0001"*	"TRACK001"*
AM	"TUAM0001"*	
TV/DVD/ SAT	"EXTD0001"*	
PC/GAME	"EXPG0001"*	

* Numrat e dosjeve dhe skedarëve më pas caktohen në mënyrë seriale.

Shënime mbi transferimin

- Gjatë transferimit (përvëç transferimit analog), nuk del tingull.
- Informacioni CD-TEXT nuk transferohet në skedarët e krijuar MP3.
- Transferimi ndalon automatikisht nëse:
 - pajisjes USB i mbaron hapësira gjatë transferimit.
 - numri i skedarëve audio dhe dosjeve në pajisjen USB arrin limitin.
- Nëse një dosje ose skedar që po përpiqeni të transferoni tashmë ekziston në pajisjen USB me të njëjtin emër, pas emrit do të shtohet një numër rendor pa mbishkruar skedarin apo dosjen origjinale.
- Ju nuk mund të kryeni veprimet e mëposhtme gjatë transferimit:
 - Nxjerrjen e diskut.
 - Zgjedhjen e një pjese ose skedari tjetër.
 - Vendosjen në pauzë të luajtjes ose gjetjen e një pike në pjesë ose skedar.
 - Ndryshimin e funksionit ose bandës së sintonizuesit.
- Kur transferoni muzikë të një Walkman® duke përdorur "Media Manager" nga WALKMAN®, sigurohuni që ta transferoni në formatin MP3.
- Kur lidhni Walkman® me sistemin, sigurohuni që ta lidhni pasi të jetë larguar ekrani "Creating Library" (Po krijohet biblioteka) ose "Creating Database" (Po krijohet baza e të dhënave) nga Walkman®.

Dëgjimi i radios

1 Shtypni në mënyrë të përsëritur **FUNCTION** për të zgjedhur bandën FM ose AM.

2 Për skanimin automatik:

Shtypni TUNING MODE në mënyrë të përsëritur derisa në panelin e ekranit të ndizet "AUTO". Më pas, shtypni TUNING+/-.

Skanimi ndalon automatikisht kur sintonizohet një stacion. "TUNED" dhe "ST" (vetëm për programet FM stereo) ndizet në panelin e ekranit. Nëse nuk ndizet "TUNED" dhe skanimi nuk ndalon, shtypni ■ për të ndaluar skanimin. Më pas, kryeni sintonizimin manual (më poshtë).

Për sintonizimin manual:

Shtypni TUNING MODE në mënyrë të përsëritur derisa nga paneli i ekranit të largohet "AUTO" dhe "PRESET". Më pas, shtypni TUNING+/- në mënyrë të përsëritur për t'u sintonizuar në stacionin që dëshironi.

Shënim

Kur sintonizoheni në një stacion FM që ofron shërbime RDS, nga transmetuesit ofrohet informacioni si p.sh. emri i shërbimit apo emri i stacionit.

Ju mund të kontrolloni informacionin RDS duke shtypur në mënyrë të përsëritur DISPLAY.

Këshillë

Për të reduktuar zhurmën statike në një stacion të dobët FM stereo, shtypni FM MODE në mënyrë të përsëritur derisa në panelin e ekranit të ndizet "MONO".

Për të ndryshuar intervalin e sintonizimit AM

(Përveç modelit për Evropën)

Cilësimi i parazgjedhur për intervalin e sintonizimit AM është 9 kHz (ose 10 kHz për disa zona). Ju nuk mund ta ndryshoni intervalin e sintonizimit AM në modalitetin e kursimit të energjisë. Përdorni butonat në njësi për ta kryer këtë veprim.

1 Shtypni TUNER/BAND në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur bandën AM.

2 Shtypni I/☺ për të fikur sistemin.

3 Ndërsa mbani shtypur OPTIONS, shtypni I/☺.

"AM 9K STEP" ose "AM 10K STEP" shfaqet në panelin e ekranit.

Kur ndryshoni intervalin, fshihen të gjitha stacionet e paravendosura AM.

Paravendosja e stacioneve të radios

Ju mund të ruani deri në 20 stacione FM dhe 10 stacione AM si stacione të preferuara.

1 Sintonizohuni në stacionin që dëshironi.

2 Shtypni TUNER MEMORY.

Numri i paravendosur



3 Shtypni TUNING+/- në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur numrin e paravendosur që dëshironi, më pas shtypni (+).

"COMPLETE" shfaqet në panelin e ekranit. Stacioni është ruajtur.

Për t'u sintonizuar në një stacion të paravendosur

Shtypni TUNING MODE në mënyrë të përsëritur derisa në panelin e ekranit të ndizet "PRESET". Më pas, shtypni TUNING+/- në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur numrin e paravendosur që dëshironi.

Bluetooth

Mbi teknologjinë Bluetooth me valë

Teknologjia *Bluetooth* me valë është një teknologji me valë me rreze të shkurtër që mundëson komunikimin e të dhënave me valë mes pajisjeve dixhitale. Teknologjia *Bluetooth* me valë funksionon brenda një rrezeje prej rreth 10 metrash (33 këmbë).

Versionet, profilet dhe kodekët e mbështetur Bluetooth

Version i mbështetur *Bluetooth*:

- *Bluetooth* Standard version 3.0 + EDR (Enhanced Data Rate)

Profilet e mbështetura *Bluetooth*:

- A2DP (Advanced Audio Distribution Profile)
- AVRCP 1.3 (Audio Video Remote Control Profile)

Kodekët e mbështetur *Bluetooth*:

- SBC (Sub Band Codec)
- AAC (Advanced Audio Coding)

Dëgjimi i muzikës me valë në një pajisje Bluetooth

Ju mund të dëgjoni muzikë nga pajisja juaj *Bluetooth* përmes një lidhjeje me valë.

Kontrolloni uebsajtet për informacion mbi pajisjet e përputhshme *Bluetooth* (faqe 32).

Mbi treguesin BLUETOOTH

Treguesi BLUETOOTH ndizet ose pulson në ngjyrë blu për të treguar statusin e *Bluetooth*.

Statusi i sistemit	Statusi i treguesit
<i>Bluetooth</i> në gjendje gatishmërie	Pulson ngadalë
<i>Bluetooth</i> duke u çiftuar	Pulson shpejt
<i>Bluetooth</i> duke u lidhur	Pulson
Është vendosur lidhja <i>Bluetooth</i>	Ndizet

Çiftimi i këtij sistemi me një pajisje *Bluetooth*

Çiftimi është një veprim ku pajisjet *Bluetooth* regjistrojnë njëra-tjetrën paraprakisht. Pasi të kryhet veprimi i çiftimit, ai nuk është nevoja të kryhet sërish. Nëse pajisja juaj është telefon smartphone i pajtueshëm me NFC, nuk është e nevojshme procedura e çiftimit manual.

1 Vendosni pajisjen *Bluetooth* brenda 1 metri (3 këmbësh) nga sistemi.

2 Shtypni BLUETOOTH në njësi për të zgjedhur funksionin *Bluetooth*.

"BLUETOOTH" shfaqet në panelin e ekranit.

Shënim

Nëse sistemi është i lidhur me një pajisje *Bluetooth*, shtypni BLUETOOTH për të shkëputur pajisjen *Bluetooth*.

3 Mbani shtypur BLUETOOTH në njësi për 2 sekonda ose më shumë.

"PAIRING" pulson në panelin e ekranit.

4 Kryeni procedurën e çiftimit në pajisjen *Bluetooth*.

Për detaje, referojuni udhëzimeve të përdorimit të pajisjes suaj *Bluetooth*.

5 Zgjidhni numrin e modelit të njësisë në ekranin e pajisjes *Bluetooth*.

Për shembull, zgjidhni "SONY:SHAKE-5".

Nëse kërkohet kod në pajisjen *Bluetooth*, vendosni kodin "0000".

6 Kryeni lidhjen *Bluetooth* në pajisjen *Bluetooth*.

Kur çiftimi kryhet dhe krijohet lidhja *Bluetooth*, në panelin e ekranit shfaqet emri i pajisjes *Bluetooth*.

Në varësi të pajisjes *Bluetooth*, lidhja mund të fillojë automatikisht pasi kryhet çiftimi.

Ju mund të kontrolloni adresën e pajisjes *Bluetooth* duke shtypur në mënyrë të përsëritur DISPLAY.

Shënime

- Ju mund të çiftoni deri në 9 pajisje *Bluetooth*. Nëse çiftohet pajisja e 10-të *Bluetooth*, pajisja që është lidhur më pak së fundi do të zëvendësohet me pajisjen e re.
- "Passkey" mund të quhet "Passcode", "PIN code", "PIN number" ose "Password", etj., në varësi të pajisjes.
- Statusi i gatishmërisë së çiftimit të sistemit anulohet pas rreth 5 minutash. Nëse çiftimi nuk është i suksesshëm, përsëriteni nga hapi 1.
- Kur është i lidhur me një pajisje *Bluetooth*, ky sistem nuk mund të diktohet dhe lidhja nuk mund të krijohet nga një pajisje tjetër *Bluetooth* që nuk është çiftuar ndonjëherë më parë.
- Nëse dëshiroi të çiftoni me një pajisje tjetër *Bluetooth*, përsëritni hapat 1 deri 6.

Për të anuluar veprimin e çiftimit

Mbani shtypur BLUETOOTH në njësi për 2 sekonda ose më shumë, derisa të shfaqet "BLUETOOTH" në panelin e ekranit.

Lidhja me një telefon smartphone me një prekje (NFC)

Duke prekur sistemin me një telefon smartphone të pajtueshëm me NFC, sistemi aktivizohet automatikisht në funksionin *Bluetooth* dhe më pas vazhdon të kryejë automatikisht çiftimin dhe lidhjen *Bluetooth*.

Çfarë është "NFC"?

NFC (Near Field Communication) është një teknologji që mundëson komunikimin me valë mes pajisjeve të ndryshme, si p.sh. telefonat celularë dhe etiketat IC. Falë funksionit NFC, komunikimi i të dhënave mund të arrihet lehtë thjesht duke prekur pikën e përcaktuar në pajisjet e pajtueshme me NFC.

1 Shkarkoni dhe instaloni aplikacionin "NFC Easy Connect".

Shkarkoni aplikacionin falas Android nga Google Play duke kërkuar "NFC Easy Connect" ose aksesojeni duke përdorur kodin dydimensional më poshtë. Mund të tarifoheni me tarifën e komunikimit të të dhënave.

Kodi dydimensional* për akses direkt

* Përdorni një aplikacion lexues për kode dydimensionale.



Shënime

- Aplikacioni mund të mos jetë i disponueshëm në disa vende/rajone.

- Në varësi të telefonit tuaj smartphone, ju mund të përdorni funksionin NFC pa e instaluar aplikacionin. Në këtë rast, veprimet dhe specifikimet mund të jenë të ndryshme. Për detaje, referojuni udhëzimeve të përdorimit të telefonit tuaj smartphone.


Telefonat smartphone të përputhshëm

Telefonat smartphone me funksion të integruar NFC (OS: Android 2.3.3 ose version më i ri, me përjashtim të Android 3.x)

2 Nisni aplikacionin "NFC Easy Connect" në telefonin tuaj smartphone.

Sigurohuni që të shfaqet ekranin e aplikacionit.

3 Prekni telefonin smartphone me Shenjën-N në sistem derisa telefoni smartphone të dridhet.



Kryeni lidhjen duke ndjekur udhëzimet e shfaqura në telefonin smartphone.

Kur krijohet lidhja *Bluetooth*, treguesi *BLUETOOTH* ndalon pulsimin dhe qëndron i ndezur. Emri i pajisjes *Bluetooth* shfaqet në panelin e ekranit. Ju mund të kaloni burimin e zërit nga një telefon smartphone në një pajisje tjetër *Bluetooth* të përputhshme me NFC.

Për detaje, referojuni udhëzimeve të përdorimit të pajisjes suaj *Bluetooth*.

Këshillë

Nëse çiftimi dhe lidhja *Bluetooth* dështojnë, veproni si më poshtë.

- Nisni sërish "NFC Easy Connect" dhe zhvendoseni telefonin smartphone me ngadalë mbi Shenjën N.
- Hiqni kasën nga telefoni smartphone nëse përdorni një kasë telefoni smartphone që tregohet në treg.

Luajtja e muzikës nga një pajisje *Bluetooth*

Ju mund të përdorni një pajisje *Bluetooth* duke lidhur sistemin dhe një pajisje *Bluetooth* duke përdorur AVRCP.

Kontrolloni si më poshtë përpara se të luani muzikë:

- Funkcioni *Bluetooth* i pajisjes *Bluetooth* është aktivizuar.
- Çiftimi është kryer.

■ Për një pajisje *Bluetooth*

1 Shtypni **BLUETOOTH** në njësi për të zgjedhur funksionin *Bluetooth*.

"BLUETOOTH" shfaqet në panelin e ekranit.

2 Krijoni lidhjen me pajisjen *Bluetooth*.

Pajisja e fundit e lidhur *Bluetooth* do të lidhet automatikisht.

Kryeni lidhjen *Bluetooth* nga pajisja *Bluetooth* nëse pajisja nuk është lidhur. Pasi krijohet lidhja, pajisja *Bluetooth* shfaqet në panelin e ekranit.

3 Shtypni ►.

- Në varësi të pajisjes *Bluetooth*,
- mund t'ju duhet ta shtypni dy herë ►.
 - mund t'ju duhet të filloni luajtjen e burimit të audios në pajisjen *Bluetooth*.

Shënime

- Kur sistemi nuk është i lidhur me ndonjë pajisje *Bluetooth*, sistemi do të lidhet dhe do të luajë nga pajisja e fundit e lidhur *Bluetooth* kur shtypni ►.
- Nëse provoni të lidhni një pajisje tjetër *Bluetooth* me sistemin, pajisja e lidhur aktualisht *Bluetooth* do të shkëputet.

■ Për një telefon smartphone të përputhshëm

Prekni telefonin smartphone me Shenjën N për të krijuar lidhjen *Bluetooth*. Filloni luajtjen e burimit të audios në telefonin smartphone. Për detaje mbi luajtjen, referojuni udhëzimeve të përdorimit të telefonit tuaj smartphone.

Për të shkëputur pajisjen *Bluetooth*

■ Për një pajisje *Bluetooth*

Shtypni **BLUETOOTH** në njësi. "BLUETOOTH" shfaqet në panelin e ekranit.

Në varësi të pajisjes *Bluetooth*, lidhja *Bluetooth* mund të anulohet automatikisht kur ndaloni luajtjen.

■ Për një telefon smartphones të përputhshëm

Prekni telefonin smartphone me Shenjën N në sistem sërish.

Fshirja e të gjithë informacionit të regjistrimit të çiftimit

Përdorni butonat në njësi për ta kryer këtë veprim.

1 Shtypni **BLUETOOTH** për të zgjedhur funksionin *Bluetooth*.

"BLUETOOTH" shfaqet në panelin e ekranit.

Nëse sistemi është i lidhur me një pajisje *Bluetooth*, emri i pajisjes *Bluetooth* shfaqet në panelin e ekranit. Shtypni **BLUETOOTH** për të shkëputur pajisjen *Bluetooth*.

2 Mbani shtypur **OPTIONS** dhe **PHASER** për rreth 3 sekonda.

"PAIR HISTORY" dhe "CLEAR" shfaqen në panelin e ekranit dhe i gjithë informacioni i çiftimit fshihet.

Vendosja e kodekëve të audios *Bluetooth*

Ju mund të zgjidhni kodekët e audios të *Bluetooth* kur pajisja *Bluetooth* e lidhur mbështet Advanced Audio Coding (AAC).

1 Shtypni **OPTIONS** në njësi.

2 Shtypni **↑/↓** në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "**BT AAC**", më pas shtypni **+**.

3 Shtypni **↑/↓** në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "**BT AAC ON**" ose "**BT AAC OFF**".

- **BT AAC ON:** Advanced Audio Coding (AAC) zgjidhet nëse pajisja *Bluetooth* mbështet AAC.
- **BT AAC OFF:** Është zgjedhur Sub Band Codec (SBC).

Shënime

- Ju mund të shijoni cilësi të lartë zëri nëse zgjidhet AAC. Në rast se nuk mund të dëgjoni tingull AAC nga pajisja juaj, zgjidhni "BT AAC OFF".
- Nëse e ndryshoni këtë cilësim gjatë kohës që sistemi është i lidhur me një pajisje *Bluetooth*, pajisja *Bluetooth* do të shkëputet. Për t'u lidhur me pajisjen *Bluetooth*, kryeni sërish lidhjen *Bluetooth*.

Vendosja/anulimi i modalitetit të gatishmërisë së *Bluetooth*

Sistemi kalon në gjendje gatishmërie të *Bluetooth* dhe pret për një lidhje *Bluetooth*, edhe kur sistemi është i fikur.

- 1 Shtypni **OPTIONS** në njësi.
- 2 Shtypni **↕/↕** në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "**BT STANDBY**", më pas shtypni **+**.
- 3 Shtypni **↕/↕** në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "**ON**" ose "**OFF**".
- 4 Shtypni **I/⏻** për të fikur sistemin.

Kur është aktivizuar modaliteti i gatishmërisë së *Bluetooth*, sistemi do të aktivizohet automatikisht kur krijoni lidhjen *Bluetooth* nga pajisja *Bluetooth*.

Shënim

Sistemi nuk do të hyjë në modalitetin e gatishmërisë së *Bluetooth* nëse fshini informacionin e çiftimit.

Rregullimi i zërit

Rregullimi i zërit

Për	Veproni kështu
Përforcimin e basit dhe krijimin e një tingulli më të fuqishëm	Shtypni BASS BAZUCA në njësi.
Reduktimin e tingullit të basit (BASS CUT)	Mbani shtypur BASS BAZUCA në njësi për 2 sekonda ose më shumë. Për të anuluar efektin BASS CUT , shtypni BASS BAZUCA sërish.
	Shënime <ul style="list-style-type: none">• Treguesi BASS BAZUCA pulson kur efekti BASS CUT aktivizohet.• Efekti BASS CUT çaktivizohet automatikisht kur fikni sistemin.
Zgjedhjen e një efekti zanor të paravendosur	Shtypni MUSIC, MOVIE/ GAME ose FOOTBALL . Për të anuluar efektin zanor të paravendosur, shtypni MUSIC në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur " FLAT ".


Krijimi i tingullit tuaj zazor personal

Ju mund të rrisni ose të ulni nivelet e brezit specifik të frekuencës dhe më pas të ruani cilësimet në memorie si "USER EQ".

1 Shtypni **OPTIONS** në njësi.

2 Shtypni **↕/↕** në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "**EQ EDIT**", më pas shtypni **⊕**.

3 Shtypni **↕/↕** në mënyrë të përsëritur për të rregulluar nivelin e balancuesit, më pas shtypni **⊕**.



4 Përsëritni hapin 3 për të rregulluar nivelin e bandave të tjera të frekuencës dhe të efektit rrethues.

Cilësimi i balancuesit nga përdoruesi ruhet kur shfaqet "USER EQ" në panelin e ekranit.

Për të shfaqur cilësimin e balancuesit nga përdoruesi

Shtypni **MUSIC** në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "USER EQ".

Krijimi i një atmosfere festive

(DJ EFFECT)

1 Shtypni butonin e mëposhtëm për të zgjedhur llojin e efektit.

Butoni i përzgjedhur ndizet dhe aktivizohet efekti.

- **FLANGER**: Krijoni një efekt të thellë "flanging" të ngjashëm me zhurmën e turbinës së një avioni reaktiv.
- **ISOLATOR**: Izoloni bandën specifike të frekuencës duke rregulluar bandat e frekuencave të tjera. Për shembull, kur dëshironi të fokusoheni te vokali, etj.
- **SOUND FLASH**: Nxirrni me ndërprerje tingullin. Tingulli ndërpritet në mënyrë periodike.
- **PHASER**: Krijoni një seri pikash kulmore dhe pikash të ulëta në spektrin e frekuencës, si një efekt fshese.

2 Shtypni **DJ CONTROL +/-** për të rregulluar nivelin e efektit.

Për të çaktivizuar efektin

Zgjidhni sërish butonin e efektit të zgjedhur.

Shënime

- DJ EFFECT çaktivizohet automatikisht kur fikni sistemin ose ndryshoni funksionin ose bandën e sintonizuesit.
- Nëse aktivizoni DJ EFFECT gjatë transfertës, efekti zazor nuk do të transferohet në pajisjen USB.
- Nuk mund ta përdorni **VOLUME/DJ CONTROL** në njësi për të rregulluar volumnin kur aktivizohet DJ EFFECT. Shtypni **VOLUME +/-** në telekomandë për të rregulluar volumnin.

Shoqërimi i këngës

Ju mund ta shoqëroni këngën e çdo burimi audio që luhet në këtë sistem.

1 Rrotulloni MIC LEVEL në MIN për të ulur nivelin e volumit të mikrofonit.

2 Lidhni një mikrofon me folenë MIC në njësi.

3 Filloni të luani muzikë dhe rregulloni volumin.

4 Rrotulloni MIC LEVEL për të rregulluar volumin e mikrofonit.

Nëse ka kthim akustike (zhurmë piskatëse) ulni volumin, lëvizeni mikrofonin larg nga altoparantët ose ndryshoni drejtimin e mikrofonit. Pasi të keni përfunduar, shkëputni mikrofonin.

Shënim

Tingulli nga mikrofoni nuk do të transferohet në pajisjen USB gjatë transferimit me USB.

Ndryshimi i motivit të ndriçimit dhe ngjyrës

Shtypni LED PATTERN ose LED COLOR për të zgjedhur motivin e ndriçimit ose ngjyrën.

Shtypni LED PATTERN ose LED COLOR për të treguar cilësimin aktual. Shtypeni sërish për të ndryshuar motivin e ndriçimit ose ngjyrën në njësi dhe altoparantë njëkohësisht.

Për të fikur ndriçimin, shtypni LED PATTERN në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "PATTERN OFF".

Përdorimi i kohëmatësve

Sistemi ofron tre funksione kohëmatësish. Ju nuk mund të aktivizoni Kohëmatësin e luajtjes dhe Kohëmatësin e regjistrimit në të njëjtën kohë. Nëse përdorni një prej tyre me Kohëmatësin e fjetjes, ka prioritet kohëmatësi i fjetjes.

Kohëmatësi i fjetjes

Ju mund të bini në gjumë duke dëgjuar muzikë. Sistemi fiket automatikisht pas kohës së paravendosur.

Shtypni në mënyrë të përsëritur SLEEP.

Për të anuluar kohëmatësin e fjetjes, shtypni SLEEP në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "SLEEP OFF".

Këshillë

Për të kontrolluar kohën e mbetur përpara se sistemi të fiket, shtypni SLEEP.

Kohëmatësi i luajtjes/ Kohëmatësi i regjistrimit

Sigurohuni që të keni vendosur orën.

Kohëmatësi i luajtjes:

Ju mund të zgjoheni në kohën e paravendosur me një disk, radio apo pajisje USB.

Kohëmatësi i regjistrimit:

Ju mund të transferoni muzikë nga një stacion i paravendosur radioje në një pajisje USB në një kohë të specifikuar.

1 Për Kohëmatësin e luajtjes:

Përgatitni burimin zanor, më pas shtypni VOLUME +/- për të rregulluar volumnin.

Për të filluar nga një pjesë ose skedar specifik, krijoni programin tuaj personal (faqe 15).

Për Kohëmatësin e regjistrimit:

Sintonizimi në një stacion radioje të paravendosur (faqe 20).

2 Shtypni TIMER MENU.

3 Shtypni \uparrow/\downarrow në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "PLAY SET" ose "REC SET", më pas shtypni \oplus .

4 Cilësoni kohën e fillimit të luajtjes ose transferimit.

Shtypni \uparrow/\downarrow në mënyrë të përsëritur për të vendosur orën/minutat, më pas shtypni \oplus .

5 Përdorni të njëjtën procedurë si në hapin 4 për të vendosur kohën e ndalimit të luajtjes ose transferimit.

6 Shtypni \uparrow/\downarrow në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur burimin që dëshironi, më pas shtypni \oplus .

Për Kohëmatësin e regjistrimit:

Lidhni një pajisje të transferueshme USB me portën ψ B.

7 Shtypni I/ \circ për të fikur sistemin.

Për të kontrolluar cilësimet e kohëmatësit ose për të aktivizuar sërish kohëmatësin

1 Shtypni TIMER MENU.
"TIMER SELECT" pulson në panelin e ekranit.

2 Shtypni \oplus .

3 Shtypni \uparrow/\downarrow në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "PLAY SELECT" ose "REC SELECT", më pas shtypni \oplus .

Për të anuluar kohëmatësin

Përsëritni të njëjtën procedurë si më lart dhe zgjidhni "TIMER OFF" në hapin step 3 dhe më pas shtypni \oplus .

Shënime

- Sistemi ndizet përpara kohës së paravendosur. Nëse sistemi ndizet në kohën e paravendosur ose nëse "STANDBY" pulson në panelin e ekranit, Kohëmatësi i luajtjes dhe Kohëmatësi i regjistrimit nuk do të luajnë apo transferojnë.
- Mos e përdorni sistemin nga koha kur sistemi ndizet derisa të fillojë luajtja ose transferimi.

Ndryshimi i afishimit

Ndryshimi i modalitetit të shfaqjes

Shtypni DISPLAY në mënyrë të përsëritur kur sistemi është i fikur.

Demonstrimi

Ekrani ndryshon dhe treguesi pulson edhe kur sistemi është i fikur.

Nuk ka afishim (Modaliteti i kursimit të energjisë)

Ekrani fiket për të kursyer energji. Kohëmatësi dhe ora vazhdojnë të funksionojnë.

Ora

Ekrani i orës kalon në automatikisht në Modalitetin e kursimit të energjisë pas pak sekondash.

Ndryshimi i motivit të spektrit të panelit të ekranit

- 1 Shtypni **OPTIONS** në njësi.
- 2 Shtypni **↕/↔** në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "**SPECTRUM**", më pas shtypni **⊕**.
- 3 Shtypni **↕/↔** në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur motivin e spektrit që dëshironi, më pas shtypni **⊕**.
Për të dalë nga menyja e opsioneve, shtypni **OPTIONS** në njësi.

Paraqitja e informacionit në panelin e ekranit

Shtypni **DISPLAY** në mënyrë të përsëritur kur sistemi është i ndezur.

Informacionin mund ta shikoni si vijon:

- Për **AUDIO CD**:
 - Kohën e kapërcyer dhe kohën e mbetur të luajtjes.
 - Kohën totale të luajtjes kur ka ndaluar luajtja.
- Për skedarët audio:
 - Kohën e kaluar e luajtjes, emrin e skedarit dhe emrin e dosjes.
 - Informacionin e titullit, artistit dhe albumit.

Shënim

Koha e kaluar e luajtjes e një skedari audio të koduar duke përdorur **VBR** (shpejtësi të ndryshueshme bitesh) nuk shfaqet saktë.

Përdorimi i pajisjeve opsionale

- 1 Shtypni **VOLUME** – vazhdimisht derisa të shfaqet "**VOLUME MIN**" në panelin e ekranit.
- 2 Lidhni një pajisje opsionale (faqe 10).
- 3 Shtypni **FUNCTION** në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur funksionin që i korrespondon pajisjes së lidhur.
- 4 Filloni të luani pajisjen e lidhur.
- 5 Shtypni **VOLUME +** në mënyrë të përsëritur të rregulluar volumin.

Shënim

(Vetëm për modelin e Evropës)
Sistemi mund të kalojë automatikisht në modalitetin e gatishmërisë nëse niveli i volumit të pajisjes së lidhur është tepër i ulët. Rregulloni nivelin e volumit të pajisjes. Për të çaktivizuar funksionin e gatishmërisë automatike, shikoni "Vendosja/anulimi i funksionit të gatishmërisë automatike (Vetëm për modelin e Evropës)" (faqe 30).

Çaktivizimi i butonave në njësi

(Blokimi për fëmijët)

Ju mund të çaktivizoni butonat në njësi (përveç I/☺) për të parandaluar keqpërdorimin, si për shembull ngacmimet që bëjnë fëmijët.

Mbani shtypur ■ në njësi për më shumë se 5 sekonda.

"CHILD LOCK" dhe "ON" shfaqen në panelin e ekranit.

Ju mund ta komandoni sistemin vetëm me anë të butonave në telekomandë. Për të anuluar, mbani shtypur ■ në njësi për më shumë se 5 sekonda derisa "CHILD LOCK" dhe "OFF" të shfaqen në panelin e ekranit.

Shënim

Funksioni i Bllokimit për fëmijët do të anulohet kur shkëputni kordonin e rrymës.

Vendosja/anulimi i funksionit të gatishmërisë automatike

(Vetëm për modelin e Evropës)

Ky sistem është i pajisur me një funksion gatishmërie automatike. Me këtë funksion, sistemi kalon automatikisht në gjendjen e gatishmërisë brenda rreth 30 minutave kur nuk përdoret ose kur nuk ka dalje sinjali audio.

Si parazgjedhje, funksioni i gatishmërisë automatike është i aktivizuar.

1 Shtypni OPTIONS në njësi.

2 Shtypni ▲/▼ në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "AUTO STANDBY", më pas shtypni ⊕.

3 Shtypni ▲/▼ në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "ON" ose "OFF".

Shënime

- Mesazhi "AUTO STANDBY" pulson në ekran rreth 2 minuta përpara se të kalojë në modalitetin e gatishmërisë.
- Funksioni i gatishmërisë automatike nuk funksionon gjatë funksionit të sintonizuesit.
- Sistemi mund të mos hyjë automatikisht në modalitetin e gatishmërisë në rastet e mëposhtme.
 - kur diktohet një sinjal audio.
 - gjatë luajtjes së skedarëve audio.
 - gjatë kohës që është në proces Kohëmatësi i luajtjes, Kohëmatësi i regjistrimit ose Kohëmatësi i fjetjes i paravendosur.

Disqet që mund të luhen

- AUDIO CD
- CD-R/CD-RW
 - të dhëna audio
 - Skedarët MP3 që janë në përputhje me ISO9660 Niveli 1/Niveli 2, ose Joliet (formati i zgjerimit).

Shënime

- MP3 (MPEG 1 Audio Layer-3) është format standard i përcaktuar nga ISO (Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit) i cili ngjesh të dhënat audio. Skedarët MP3 duhet të jenë në formatin MPEG 1 Audio Layer-3.
- Sistemi mund të luajë vetëm skedarët MP3 që kanë një prapashitesë skedari ".mp3".

Disqet që nuk mund të luhen

- CD-ROM
- CD-R/CD-RW që ka kushtet e mëposhtme:
 - Regjistruar në formatin MP3 PRO
 - Regjistruar në shumë sesione që nuk kanë përfunduar me "mbyllje të sesionit"
 - Regjistruar me një pajisje regjistrimi të papërputhshme
 - Cilësi e dobët regjistrimi
 - Gërvishnje ose papastërti
 - Finalizuar në mënyrë të pasaktë
- Disqe me formë jostandarde (p.sh. formë zemre, katrorë, ylli etj.)
- Disqet që kanë shirit adeziv, letër apo ngjitëse të ngjitur mbi to
- Disqet me qira ose të përdorura me ngjitëse ku ngjitësi kalon përtej vulosjes
- Disqet që kanë etiketa të printuara me bojë që është ngjitëse kur preket

Shënime mbi DualDiscs

Një DualDiscs është një disk me dy anë që ka material të regjistruar DVD në njërin anë me material dixhital audio nga ana tjetër. Megjithatë, duke qenë se ana e materialit audio nuk është e përputhshme me standardin Compact Disc (CD) luajtja në këtë produkt nuk garantohehet.

Disqet muzikore të koduara me teknologji të mbrojtjes së të drejtave të autorit

Ky produkt është projektuar të luajë disqe që janë në përputhje me standardin Compact Disc (CD). Kohët e fundit, disa kompani muzikore tregojnë disqe të ndryshme muzikore me teknologji për mbrojtjen e drejtës së autorit. Kini parasysh se mes këtyre disqeve, ka disa që nuk përputhen me standardin CD dhe mund të mos luhen nga ky produkt.

Shënime mbi luajtjen e disqeve me shumë sesione

- Ky sistem mund të luajë disqe me shumë sesione kur në sesionin e parë ndodhet një skedar MP3. Çdo skedar i mëpashtëm MP3 i regjistruar në sesionet e mëvonshme mund të luhet gjithashtu (nëse sesionet e mëvonshme përmbajnë format AUDIO CD, sistemi nuk mund të luajë këtë disk me shumë sesione).
- Nëse sesioni i parë regjistrohet në formatin AUDIO CD, do të luhet vetëm sesioni i parë.

Uebsajtet për pajisjet e përputhshme

Kontrolloni uebsajtet e mëposhtme për informacionin më të fundit mbi pajisjet e përputhshme USB dhe *Bluetooth*.

Për klientët në Amerikën Latine:

<<http://esupport.sony.com/LA>>

Për klientët në Shtetet e Bashkuara:

<<http://www.esupport.sony.com/>>

Për klientët në Evropë:

<<http://support.sony-europe.com/>>

Për klientët në vendet/rajonet e tjera:

<<http://www.sony-asia.com/support>>

Zgjidhja e problemeve

Nëse hasni një problem me sistemin tuaj, gjejini problemin në listën e mëposhtme të zgjidhjes së problemeve dhe merrni masën korrigjuese.

Nëse problemi vazhdon, konsultohuni me shitësin më të afërt të Sony.

Vini re se nëse personeli i shërbimit ndërron disa pjesë gjatë riparimit, ata mund t'i mbajnë këto pjesë.

Nëse në panelin e ekranit shfaqet "PROTECT EXX" (X është numër)

Menjherë shkëpusni kordonin e rrymës dhe kontrolloni si më poshtë.

- A po përdorni vetëm altoparlantët e dhënë?
- A po bllokoni diçka vrimat e ajrosjes së njësisë?

Pasi të kontrolloni artikujt e mësipërm dhe të rregulloni problemet e mundshme, vendosni sërish në prizë kordonin e rrymës dhe ndizeni sistemin. Nëse problemi vazhdon, konsultohuni me shitësin më të afërt të Sony.

Të përgjithshme

Sistemi ka kaluar në modalitetin e gatishmërisë.

- Ky nuk është keqfunksionim. Sistemi kalon automatikisht në gjendjen e gatishmërisë brenda rreth 30 minutave kur nuk përdoret ose kur nuk ka dalje sinjali audio (faqe 30).

Është anuluar vendosja e orës ose e kohëmatësit.

- Kordoni i rrymës është shkëputur ose ka ndodhur ndërprerje e rrymës elektrike. Vendosni orën (faqe 12) dhe kohëmatësin (faqe 27) sërish.

Nuk ka zë.

- Rregulloni volumnin.
- Kontrolloni lidhjet e altoparlantit (faqe 10).
- Kontrolloni lidhjen e pajisjeve opsionale, nëse ka (faqe 10).
- Ndizni pajisjen e lidhur.
- Nuk ka dalje audio gjatë Kohëmatësit të regjistrimit.

Nuk ka zë nga mikrofoni.

- Rregulloni volumnin e mikrofonit.
- Sigurohuni që mikrofoni të jetë lidhur mirë me folenë MIC.
- Sigurohuni që mikrofoni të jetë aktivizuar.

Ka gumëzhitje ose zhurmë të madhe.

- Lëvizeni sistemin larg nga burimet e zhurmës.
- Lidhni sistemin me një prizë tjetër muri.
- Instaloni një filtër zhurme (e disponueshme në njësi tregtare) me kordonin e rrymës.
- Fikni pajisjet elektrike rrethuese.

Kohëmatësi nuk funksionon.

- Kontrolloni cilësimet e kohëmatësit dhe vendosni kohën e duhur (faqe 27).
- Anuloni funksionin e Kohëmatësit të fjetjes (faqe 27).

Telekomanda nuk funksionon.

- Hiqni pengesat mes telekomandës dhe njësisë.
- Zhvendoseni telekomandën më pranë njësisë.
- Drejtojeni telekomandën te sensori i njësisë.
- Zëvendësoni bateritë (R6/përmasa AA).
- Lëvizeni njësinë larg nga dritat fluoeshente.

Ka kthim të akustikës.

- Ulni volumin.
- Lëvizeni mikrofonin larg nga altoparantët ose ndryshoni drejtimin e mikrofonit.

Shfaqet "CHILD LOCK" kur shtypni një buton në njësi.

- Çaktivizoni funksionin e bllokimit për fëmijët (faqe 30).

Altoparantët**Del zë nga njëri kanal ose volumi i majtë dhe i djathtë është i pabalancuar.**

- Vendosini altoparantët sa më simetrikisht që të jetë e mundur.
- Kontrolloni që altoparantët të jenë lidhur mirë dhe saktë.
- Burimi që luhet është mono.

Nuk del zë nga një altoparant i caktuar.

- Kontrolloni që altoparanti të jetë lidhur mirë dhe saktë.

Luajtësi i diskut**Sirtari i diskut nuk hapet dhe në panelin e ekranit shfaqet "LOCKED".**

- Konsultohuni me shitësin më të afërt të Sony ose pikën lokale të autorizuar të shërbimit të Sony.

Sirtari i diskut nuk mbyllet.

- Ngarkojeni diskut saktë.

Sirtari i diskut nuk del.

- Nuk mund ta nxirrni diskut gjatë veprimeve të mëposhtme CD-USB Transferimi i sinkronizuar ose REC1 Transferimi. Shtypni ■ për të anuluar transferimin, më pas shtypni ▲ OPEN/CLOSE në njësi për të nxjerrë diskut.
- Konsultohuni me shitësin më të afërt të Sony.

Luajtja nuk fillon.

- Pastroni diskut duke e fshirë (faqe 38).
- Ringarkojeni diskut.
- Ngarkoni disqe që ky sistemi mund të luajë (faqe 31).
- Hiqeni diskut dhe fshini lagështirën në disk, më pas lëreni sistemin të ndezur për pak orë derisa të avullojë lagështira.

Zëri kapërcehet.

- Pastroni diskut duke e fshirë (faqe 38).
- Ringarkojeni diskut.
- Lëvizeni njësinë në një vend pa dridhje (p.sh. mbi një mbajtëse të qëndrueshme).
- Lëvizini altoparantët larg njësisë, ose vendosini ato mbi mbajtëse të ndara. Kur dëgjoni një pjesë me tinguj basi me volume të larta, dridhja e altoparantit mund të bëjë që të kapërcehet tingulli.

Luajtja nuk fillon nga pjesa e parë.

- Vendoseni modalitetin e luajtjes në Luajtja normale (faqe 14).

Emri i dosjes, emri i pjesës, emri i skedarit dhe karakteret ID3 nuk shfaqen si duhet.

- Etiketa ID3 nuk është Version 1(1.0/1.1) dhe Version 2(2.2/2.3).
- Kodet e karaktereve që mund të shfaqen nga ky sistem janë si më poshtë:
 - Shkronjat e mëdha (A deri Z)
 - Numrat (0 deri 9)
 - Simbolet (< > * +, [] \ _)
 Karakteret e tjera shfaqen si "_".

Transferimi rezulton në gabim.

- Ju po përdorni një pajisje të pambështetur USB. Kontrolloni informacionin në uebsajte mbi pajisjet e përputhshme USB (faqe 32).
- Pajisja USB nuk është formatuar saktë. Referojuni udhëzimeve të përdorimit të pajisjes USB mbi mënyrën e formatimit.
- Fikni sistemin dhe hiqni pajisjen USB. Nëse pajisja USB ka çelës rryme, fikeni dhe ndizeni sërish pajisjen USB pasi ta hiqni nga sistemi. Më pas kryejeni transferimin sërish.
- Nëse transferimi dhe fshirja përsëriten disa herë, struktura e skedarëve brenda pajisjes USB fragmentohet. Referojuni udhëzimeve të përdorimit të dhëna me pajisjen USB për mënyrën e trajtimit të këtij problemi.
- Pajisja USB është shkëputur ose është fikur rryma gjatë transferimit. Fshini skedarin e transferuar pjesërisht dhe kryeni sërish transferimin. Nëse kjo nuk e rregullon problemin, pajisja USB mund të jetë prishur. Referojuni udhëzimeve të përdorimit të pajisjes USB mbi mënyrën e trajtimit të këtij problemi.

Skedarët audio ose dosjet në pajisjen USB nuk mund të fshihen.

- Kontrolloni nëse pajisja USB është e mbrojtur ndaj shkrimit.
- Pajisja USB është shkëputur ose është fikur rryma gjatë fshirjes. Fshini skedarin e fshirë pjesërisht. Nëse kjo nuk e rregullon problemin, pajisja USB mund të jetë prishur. Referojuni udhëzimeve të përdorimit të pajisjes USB mbi mënyrën e trajtimit të këtij problemi.

Nuk ka zë.

- Pajisja USB nuk është lidhur mirë. Fikni sistemin dhe rilidhni pajisjen USB, më pas ndizeni sistemin dhe kontrolloni nëse "USB A" ose "USB B" ndizet në panelin e ekranit.

Ka zhurmë, zëri kapërcehet ose është i shtrembëruar.

- Ju po përdorni një pajisje të pambështetur USB. Kontrolloni informacionin në uebsajte mbi pajisjet e përputhshme USB (faqe 32).
- Fikni sistemin dhe rilidhni pajisjen USB, më pas ndizeni sistemin.
- Vetë të dhënat muzikore përmbajnë zhurmë, ose tingulli është i shtrembëruar. Mund të ketë hyrë zhurmë gjatë procesit të transferimit. Fshini skedarin dhe provoni të kryeni sërish transferimin.
- Shpejtësia bit e përdorur gjatë kodimit të skedarëve audio është e ulët. Dërgoni skedarët audio me shpejtësi bit më të lartë në pajisjen USB.

"READING" shfaqet për një periudhë të gjatë kohe, ose duhet shumë përparesë të fillojë luajtja.

- Procesi i leximit kërkon shumë kohë në rastet e mëposhtme.
 - Ka shumë dosje ose skedarë në pajisjen USB (faqe 14).
 - Struktura e skedarëve është jashtëzakonisht komplekse.
 - Është tejkaluar kapaciteti i memories.
 - Memoria e brendshme është e fragmentuar.

Shfaqet "OVER CURRENT".

- Është diktuar një problem me nivelin e rrymës elektrike nga porta ψ A ose porta ψ B. Fikni sistemin dhe hiqni pajisjen USB nga porta. Sigurohuni që të mos ketë probleme me pajisjen USB. Nëse vazhdon problemi me ekranin, kontaktoni me shitësin më të afërt të Sony.

Afishim me gabime.

- Të dhënat e ruajtura në pajisjen USB mund të jenë dëmtuar, kryeni sërish transferimin.
- Kodet e karaktereve që mund të shfaqen nga ky sistem janë si më poshtë:
 - Shkronjat e mëdha (A deri Z)
 - Numrat (0 deri 9)
 - Simbolet (< > * +, [] \ _)
 Karakteret e tjera shfaqen si " ".

Pajisja USB nuk njihet.

- Fikni sistemin dhe rilidhni pajisjen USB, më pas ndizni sistemin.
- Kontrolloni informacionin në uebsajte mbi pajisjet e përputhshme USB (faqe 32).
- Pajisja USB nuk funksionon mirë. Referojuni udhëzimeve të përdorimit të pajisjes USB mbi mënyrën e trajtimit të këtij problemi.

Luajtja nuk fillon.

- Fikni sistemin dhe rilidhni pajisjen USB, më pas ndizni sistemin.
- Kontrolloni informacionin në uebsajte mbi pajisjet e përputhshme USB (faqe 32).

Luajtja nuk fillon nga skedari i parë.

- Vendoseni modalitetin e luajtjes në Luajtja normale (faqe 14).

Skedari audio nuk mund të luhet.

- Pajisjet USB të formatuara me sisteme skedarësh ndryshe nga FAT16 or FAT32 nuk mbështeten*.
- Nuk mund të luhet një skedar audio WMA që është në formatin WMA DRM, WMA Lossless, ose WMA PRO.
- Nuk mund të luhet një skedar audio AAC që është në formatin AAC DRM ose AAC Lossless.
- Skedarët audio AAC të koduar në 96 kHz nuk mund të luhen.
- Në rast se ekzistojnë ndarje të shumta në pajisjen USB që po përdoret, skedarët nuk mund të luhen.
- Sistemi mund të luajë vetëm deri në një thellësi prej 8 dosjesh.

- Skedarët që janë të enkriptuar ose të mbrojtur me fjalëkalime etj. nuk mund të luhen.
- Skedarët me mbrojtje të të drejtave të autorit DRM (Digital Rights Management) nuk mund të luhen në këtë sistem.
- Skedari audio MP3 PRO mund të luhet si skedar audio MP3.

* Ky sistem mbështet FAT16 dhe FAT32, por disa pajisje USB mund të mos i mbështesin të gjitha këto FAT. Për detaje, referojuni udhëzimeve të përdorimit të secilës pajisje USB ose kontaktoni me prodhuesin.

Sintonizuesi**Ka gumëzhitje ose zhurmë të fortë, ose nuk arrihen të kapen stacionet. ("TUNED" ose "ST" pulson në panelin e ekranit).**

- Lidhni antenën mirë.
- Ndryshoni vendndodhjen e antenës dhe orientimin për të pasur marrje të mirë.
- Lidhni një antenë të jashtme të disponueshme në njësi tregtare.
- Konsultohuni me shitësin më të afërt të Sony nëse antena e dhënë AM ka dalë nga mbajtësja plastike.
- Fikni pajisjet elektrike rrethuese.

Pajisja Bluetooth**Çiftimi nuk mund të kryhet.**

- Lëvizeni pajisjen *Bluetooth* më pranë sistemit.
- Çiftimi mund të mos jetë i mundur nëse rrotulli sistemi ka të pranishme pajisje të tjera *Bluetooth*. Në këtë rast, fikni pajisjet e tjera *Bluetooth*.
- Sigurohuni që të jetë vendosur kodi i saktë në pajisjen *Bluetooth*.

Lidhja nuk është e mundur.

- Pajisja *Bluetooth* që po provoni të lidhni nuk mbështet profilin 2DP dhe nuk mund të lidhet me sistemin.
- Aktivizoni funksionin *Bluetooth* të pajisjes *Bluetooth*.
- Krijoni një lidhje nga pajisja *Bluetooth*.
- Informacioni i regjistrimit të çiftimit është fshirë. Kryeni sërish veprimin e çiftimit.
- Kur është i lidhur me një pajisje *Bluetooth*, ky sistem nuk mund të diktohet dhe nuk mund të krijohet lidhje nga një pajisje tjetër *Bluetooth* që nuk është çiftuar ndonjëherë më parë.
- Fshini informacionin e regjistrimit të çiftimit të pajisjes *Bluetooth* device (faqe 24) dhe kryeni sërish operacionin e çiftimit (faqe 21).

Zëri kapërcehet ose luhet ose lidhja ka humbur.

- Sistemi dhe pajisja *Bluetooth* janë tepër larg njëra-tjetres.
- Nëse ka pengesa mes sistemit dhe pajisjes *Bluetooth*, hiqni ose shmangni pengesat.
- Nëse ka ndonjë pajisje që krijon rrezatim elektromagnetik, si p.sh. LAN me valë, pajisje tjetër *Bluetooth*, ose një furrë me mikrovalë, largojini ato.

Tingulli i pajisjes *Bluetooth* nuk mund të dëgjohet nga ky sistem.

- Rrisni në fillim volumnin në pajisjen *Bluetooth* dhe më pas rregulloni volumnin duke përdorur VOLUME +/-.

Ka gumëzhitje dhe zhurmë të fortë, ose zëri është i shtrembëruar.


- Nëse ka pengesa mes sistemit dhe pajisjes *Bluetooth*, hiqni ose shmangni pengesat.
- Nëse ka ndonjë pajisje që krijon rrezatim elektromagnetik, si p.sh. LAN me valë, pajisje tjetër *Bluetooth*, ose një furrë me mikrovalë, largojini ato.
- Ulni volumnin e pajisjes së lidhur *Bluetooth*.


Për të rivendosur sistemin

Nëse sistemi vazhdon të mos funksionojë mirë, rivendosni sistemin në gjendje fabrike.

Përdorni butonat në njësi për ta kryer këtë veprim.

1 Hiqni nga priza kordonin elektrik dhe vendoseni sërish.

2 Shtypni  për të ndezur sistemin.

3 Mbani shtypur  dhe LED COLOR në të njëjtën kohë për rreth 3 sekonda. "RESET" shfaqet në panelin e ekranit. Të gjitha cilësimet e konfiguruar nga përdoruesi, si p.sh. stacionet e paravendosura të radios dhe ora, rivendosen në gjendje fabrike.

Mesazhet

Një nga mesazhet e mëposhtme mund të shfaqet ose të pulsojë në panelin e ekranit gjatë përdorimit.

CANNOT PLAY

Është futur një disk që nuk mund të luhet.

DEVICE ERROR

Pajisja USB nuk njihet ose është lidhur një pajisje e panjohur.

DEVICE FULL

Memoria e pajisjes USB është plot.

FATAL ERROR

Pajisja USB është hequr gjatë transferimit ose fshirjes dhe mund të jetë dëmtuar.

FOLDER FULL

Ju nuk mund të transferoni në pajisjen USB sepse është arritur maksimumi i dosjeve.

NO DEVICE

Nuk është lidhur asnjë pajisje USB.

NO DISC

Nuk ka disk në sirtarin e diskut.

NO MEMORY

Memoria e zgjedhur për luajtjen ose transferimin nuk ka mjet memorieje të futur në pajisjen USB.

NO STEP

Janë fshirë të gjitha hapat e programuara.

NO TRACK

Nuk është ngarkuar në sistem një skedar që mund të luhet.

NOT IN USE

Keni provuar të kryeni një veprim specifik në kushte ku ai veprim ndalohet.

NOT SUPPORTED

Është lidhur një pajisje e pambështetur USB ose pajisja USB është lidhur përmes një qendre USB.

OFF TIME NG

Koha e nisjes dhe e fikjes së Kohëmatësit të luajtjes ose Kohëmatësit të regjistrimit është e njëjtë.

PROTECTED

Pajisja USB është e mbrojtur ndaj shkrimit.

PUSH STOP

Keni provuar të kryeni një veprim që mund të kryhet vetëm kur ndalohet luajtja.

READING

Sistemi po lexon informacionin e diskut ose të pajisjes USB. Disa funksione janë të padisponueshme.

REC ERROR

Transferimi nuk ka nisur, ka ndaluar në gjysmë, ose nuk ka arritur të kryhet.

STEP FULL

Keni provuar të programoni më shumë se 25 hapa.

TRACK FULL

Ju nuk mund të transferoni në pajisjen USB sepse është arritur maksimumi i skedarëve.

UNLOCKED

Është aktivizuar funksioni kundër vjedhjes së diskut.

Masat paraprake

Kur transportoni njësinë

Kryeni procedurën e mëposhtme për të mbrojtur mekanizmin e diskut. Përdorni butonat në njësi për ta kryer këtë veprim.

1 Shtypni I/☐ për të ndezur sistemin.

2 Shtypni CD.

3 Hiqni diskut.

Shtypni ▲ OPEN/CLOSE për të hapur ose mbyllur sirtarin e diskut.

Prisni derisa "NO DISC" të shfaqet në panelin e ekranit.

4 Mbani shtypur CD dhe FLANGER për 3 sekonda.

"MECHA LOCK" shfaqet në panelin e ekranit.

5 Hiqni nga priza kordonin e rrymës.

Shënime mbi disqet

- Përpara luajtjes, fshini diskut me një pëlhurë pastrimi nga qendra drejt cepave.
- Mos fshini disqet me tretës, si p.sh. benzinë, dyliente, apo pastrues të disponueshëm në njësi tregtare apo spërkatës antistatikë për disqet e vinilit LP.
- Mos i ekspozoni disqet ndaj dritës së drejtpërdrejtë të diellit apo burimeve të nxehtësisë, si p.sh. në tubacionet e ajrit të nxehtë, as mos i lini në një makinë të parkuar nën dritën e drejtpërdrejtë të diellit.

Mbi sigurinë

- Shkëputni krejtësisht kordonin e rrymës (kablloën e rrymës elektrike) nga priza e murit, nëse nuk do të përdoret për një periudhë të gjatë kohe. Kur shkëputni njësinë nga priza, gjithmonë kapeni nga priza. Mos e tërhiqni asnjëherë vetë kordonin.
- Nëse në sistem bien objekte të forta apo lëngje, shkëputni sistemin nga rryma dhe dërgojeni për kontroll nga një personel i të kualifikuar përpara se ta përdorni sërish.

- (Vetëm për klientët në Shtetet e Bashkuara) Njëri kunj i spinës është më i gjerë se tjetri për efekt sigurie dhe futet në prizën e murit vetëm në një drejtim. Nëse nuk arrini ta fusni spinën plotësisht në prizë, kontaktoni me shitësin.
- Kordoni i rrymës elektrike AC duhet të ndërrohet vetëm pranë një pike shërbimi të kualifikuar.

Mbi vendosjen

- Mos e vendosni sistemin në një pozicion të pjerrët ose në vende ku është jashtëzakonisht nxehtë, ftohtë, me pluhur, me papastërti ose me ventilim të papërshtatshëm ose ku ka dridhje, dritë dielli të drejtpërdrejtë ose dritë të fortë.
- Kini kujdes kur e vendosni njësinë ose altoparlantët mbi sipërfaqe me trajtim të veçantë (p.sh. dyllë, vaj, lustër) sepse mund të rezultojnë njolla ose çngjyrosje.
- Nëse sistemi sillet direkt nga një vend i ftohtë në një të nxehtë, ose vendoset në një dhomë shumë të lagësht, lagështira mund të kondensohet në lentet brenda njësisë dhe të bëjë që sistemi të keqfunksionojë. Në këtë rast, hiqni diskut dhe lëreni sistemin të ndezur për rreth një orë derisa të avullojë lagështira.

Mbi akumulimin e nxehtësisë

- Akumulimi i nxehtësisë gjatë funksionimit është normal dhe nuk përbën shkak për t'u alarmuar.
- Mos e prekni kasën e pajisjes nëse është përdorur vazhdimisht me volum të lartë sepse kasa mund të jetë nxehtë.
- Mos pengoni vrimat e ajrosjes.

Mbi sistemin e altoparlantëve

Ky sistem altoparlantësh nuk është me mbrojtje magnetike dhe pamja në televizorët pranë mund të distortohej magnetikisht. Në këtë rast, fikni televizorin, prisni 15 deri 30 sekonda, dhe ndizeni sërish. Nëse nuk ka përmirësim, zhvendosni altoparlantët shumë larg televizorit.

Pastrimi i kasës së pajisjes

Pastrojeni këtë sistem me një pëlhurë të butë, disi të njomur me solucion të butë larës. Mos përdorni asnjë lloj shtupe gërryese, pluhur pastrues apo tretës, si holluesit, benzina, ose alkooli.

Mbi komunikimin *Bluetooth*

- Pajisjet *Bluetooth* duhet të përdoren brenda afërsisht 10 metra (33 këmbë) (distancë pa pengesa) nga njëra-tjetra. Rrezja e efikasë e komunikimit mund të shkurtohet në kushtet e mëposhtme.
 - Kur mes pajisjeve me lidhje *Bluetooth* ndodhet një person, objekt metalik, mur apo pengesë tjetër
 - Vendndodhjet ku është instaluar një LAN me valë
 - Rreth furrave me mikrovalë që janë në përdorim
 - Vendndodhjet ku ka valë të tjera elektromagnetike
- Pajisjet *Bluetooth* dhe LAN me valë (IEEE 802.11b/g) përdorin të njëjtin brez frekuence (2,4 GHz). Kur përdorni pajisjen tuaj *Bluetooth* pranë një pajisjeje me kapacitet LAN me valë, mund të ndodhin interferenca elektromagnetike. Kjo mund të sjellë shpejtësi më të ulëta të transferimit të të dhënave, zhurmë ose pamundësi për t'u lidhur. Nëse ndodh kjo, provoni zgjidhjet e mëposhtme:
 - Provoni ta lidhni këtë sistem dhe pajisjen *Bluetooth* kur jeni të paktën 10 metra (33 këmbë) larg nga pajisja LAN me valë.
 - Fikni rrymën e pajisjes LAN me valë kur përdorni pajisjen tuaj *Bluetooth* brenda 10 metrave (33 këmbë).
- Valët radio të transmetuara nga ky sistem mund të interferojnë në funksionimin e pajisjeve mjekësore. Duke qenë se kjo interferencë mund të sjellë keqfunksionim, fikni gjithmonë rrymën e këtij sistemi dhe pajisjes *Bluetooth* në vendet e mëposhtme:
 - Në spitale, trena, aeroplanë, pika karburanti dhe vende ku mund të ketë gaze të djegshme
 - Pranë detyrës automatike ose alarmeve të zjarrit
- Ky sistem mbështet funksionet e sigurisë që përpunohen me specifikimin *Bluetooth* si një mënyrë për të garantuar sigurinë gjatë komunikimit me teknologjinë *Bluetooth*. Megjithatë, kjo siguri mund të jetë e pamjaftueshme në varësi të përbajtjes së cilësimit dhe faktorëve të tjerë, prandaj gjithmonë kini kujdes kur kryeni komunikimin duke përdorur teknologjinë *Bluetooth*.
- Sony nuk është përgjegjës për asnjë mënyrë dëmtimi apo humbje tjetër si rezultat i rrjedhjes së informacionit gjatë komunikimit duke përdorur teknologjinë *Bluetooth*.
- Komunikimi *Bluetooth* nuk është domosdoshmërisht i garantuar me të gjitha pajisjet *Bluetooth* që kanë të njëjtin profil si ky sistem.
- Pajisjet *Bluetooth* të lidhura me këtë sistem duhet të përpunohen me specifikimin *Bluetooth* të përshkruar nga *Bluetooth SIG, Inc.* dhe duhet të jenë të certifikuara si të përpunueshme. Megjithatë, edhe kur një pajisje përpunohet me specifikimin *Bluetooth*, mund të ketë raste kur karakteristikat apo specifikimet e pajisjes *Bluetooth* mund ta bëjnë të pamundur lidhjen, ose mund të rezultojnë në metoda të ndryshme kontrolli, paraqitjeje apo funksionimi.
- Mund të shkaktohet zhurmë ose audioja mund të ndërpritet në varësi të pajisjes *Bluetooth* që është lidhur me këtë sistem, mjedisin e komunikimeve apo kushtet rrethuese.

Specifikimet

SPECIFIKIMET E FUQISË AUDIO

DALJA E FUQISË DHE DISTORSIONI TOTAL HARMONIK: (Vetëm modeli i SH.B.A.)

Me ngarkesa 4 om, me të dyja kanalet në funksionim, nga 120 – 10 000 Hz; 150 vat nominale për fuqi minimale RMS në kanal, me jo më pak se 1% distorsion total harmonik nga 250 milivat në dalje nominale.

Seksioni i amplifikatorit

Të mëposhtmet janë matur në

Modeli i SH.B.A.-së:

AC 120 V, 60 Hz

Modeli i Meksikës:

AC 120 V – 240 V, 60 Hz

Modeli evropian:

AC 220 V – 240 V, 50/60 Hz

Modelet e tjera:

AC 120 V – 240 V, 50/60 Hz

Altoparlantët për frekuenca të larta/Altot

Dalja e fuqisë (nominale):

350 W + 350 W (në 4 om, 1 kHz, 1% THD)

Dalja RMS e fuqisë (e referuar):

600 W + 600 W (për kanal në 4 om, 1 kHz)

Baset

Dalja e fuqisë (nominale):

350 W + 350 W (në 4 om, 100 Hz, 1% THD)

Dalja RMS e fuqisë (e referuar):

600 W + 600 W (për kanal në 4 om, 100 Hz)

Hyrjet

TV/DVD/SAT (AUDIO IN) L/R

Tensioni 2 V, rezistenca 47 kilo-om

PC/GAME (AUDIO IN) L/R

Tensioni 2 V, rezistenca 47 kilo-om

MIC

Ndjeshmëria 1 mV, rezistenca

10 kilo-om

Porta Ψ A (USB), Ψ B (USB): Lloji A

Seksioni për USB

Shpejtësia në bit e mbështetur

WMA:

48 kbps – 192 kbps, VBR, CBR

AAC:

48 kbps – 320 kbps, VBR, CBR

Frekuencat shembull

WMA: 44,1 kHz

AAC: 44,1 kHz

Pajisja e mbështetur USB

Kategori e ruajtjes në masë

Rryma maksimale

500 mA

Seksioni i diskut/USB

Shpejtësia në bit e mbështetur

MPEG1 Layer-3:

32 kbps – 320 kbps, VBR

MPEG2 Layer-3:

8 kbps – 160 kbps, VBR

MPEG1 Layer-2:

32 kbps – 384 kbps, VBR

Frekuencat shembull

MPEG1 Layer-3:

32 kHz/44,1 kHz/48 kHz

MPEG2 Layer-3:

16 kHz/22,05 kHz/24 kHz

MPEG1 Layer-2:

32 kHz/44,1 kHz/48 kHz

Seksioni i luajtësit të disqeve

Sistemi

Sistem kompakt disk dhe audio dixhitale

Vetitë e lazerit diodik

Kohëzgjatja e emetimit: E vazhdueshme

Dalja lazer*: Më pak se 44,6 μ W

* Kjo dalje është masa e vlerës në një distancë prej 200 mm nga sipërfaqja e lentes së objektivit në bllokun marrës optik me hapje 7 mm.

Reagimi i frekuencës

20 Hz – 20 kHz

Raporti sinjal-zhurmë

Më shumë se 90 dB

Variacioni dinamik

Më shumë se 88 dB

Seksioni i sintonizuesit

FM stereo, sintonizues FM/AM superheterodin

Antena:

Antenë përcjellëse FM

Antenë AM në formë kornize

Seksioni i sintonizuesit FM

Diapazoni i sintonizimit

Modeli i SH.B.A.-së:

87,5 MHz – 108,0 MHz (hapa 100 kHz)

Modelet e tjera:

87,5 MHz – 108,0 MHz (hapa 50 kHz)

Seksioni i sintonizuesit AM

Diapazoni i sintonizimit

Modeli evropian:

531 kHz – 1602 kHz (hapa 9 kHz)

Modelet e tjera:

531 kHz – 1710 kHz (hapa 9 kHz)

530 kHz – 1710 kHz (hapa 10 kHz)

Seksioni Bluetooth

Sistemi i komunikimit

Bluetooth Standard version 3.0 + EDR (Enhanced Data Rate)

Dalje

Bluetooth Standard Power Class 2

Rrezja maksimale e komunikimit

Rrezja e shikimit rreth 10 m¹⁾

Brez i frekuencës

Brez i 2,4 GHz (2,4000 GHz – 2,4835 GHz)

Metoda e modulimit

FHSS (Freq Hopping Spread Spectrum – Spektri i spondit të kapërcimit të frekuencës)

Profillet e përputhshme *Bluetooth*²⁾

A2DP (Advanced Audio Distribution Profile)

AVRCP 1.3 (Audio Video Remote Control Profile)

Kodekët e mbështetur

SBC (Sub Band Codec)

AAC (Advanced Audio Coding)

¹⁾ Rrezja aktuale varion në varësi të faktorëve si pengesat mes pajisjeve, fushat magnetike rreth një furre me mikrovalë, elektriciteti statik, ndjeshmëria e marrjes, performanca e antenës, sistemi operativ, aplikacioni i softuerit etj.

²⁾ Profillet standard *Bluetooth* tregojnë qëllimin e komunikimit *Bluetooth* mes pajisjeve.

Altoparlantët

Sistemi i altoparlantëve

3 drejtime, Refleksi i basit

Njësia e altoparlantit

Altot: 200 mm (8 inç), lloji konik

Altoparlantët për frekuenca të larta:

25 mm (1 inç), lloji bri

Base: 350 mm (14 inç), lloji konik

Rezistenca nominale

4 om

Përmasat (gj/l/th) (afërsisht)

490 mm × 660 mm × 360 mm

(19 ³/₈ inç × 26 inç × 14 ¹/₄ inç)

Masa (afërsisht)

26,5 kg (58 lb 7 oz)

Sasia: 2 copë

Të përgjithshme

Furnizimi me energji

Modeli i SH.B.A.-së:

AC 120 V, 60 Hz

Modeli i Meksikës:

AC 120 V – 240 V, 60 Hz

Modeli evropian:

AC 220 V – 240 V, 50/60 Hz

Modelet e tjera:

AC 120 V – 240 V, 50/60 Hz

Konsumi i energjisë

370 W (0,5 W në modalitetin
e kursimit të energjisë)

Përmasat (gj/l/th) (pa altoparlantët) (afërsisht)

505 mm × 160 mm × 350 mm

(20 inç × 6 ³/₈ inç × 13 ⁷/₈ inç)

Masa (pa altoparlantët) (afërsisht)

6,0 kg (13 lb 4 oz)

Aksesorët shoqërues

Telekomanda (1)

R6 (Bateri përmasa AA) (2)

Antenë përcjellëse FM/Antena

qarkore AM (1)

Paneli i poshtëm (1)

Dizajni dhe specifikimet i nënshtrohen
ndryshimit pa dhënë njoftim.

<http://www.sony.net/>



©2013 Sony Corporation



* 4 4 6 2 8 1 6 1 2 * (1)